

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6100  
E shtunë, 29 gusht 2020  
çmimi 0.40 €

## Bie numri i vdekjeve nga Covidi në Kosovë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA | FAQE 4-5

## LDK-ja E KA MONOPOLIZUAR PROCESIN E DIALOGUT



Analisti politik Behxhet Shala ka thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e ka monopolizuar procesin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se duke pasur dy postet

kryesore që kanë të bëjnë me këtë proces, LDK-ja ia ka dhënë vetes të drejtën për ta përfaqësuar Kosovën në dialogun e Brukselit dhe të Uashingtonit. Shala e ka kritikuar qasjen kryeministrit në raport me partitë opoz-

itare në këtë proces. Ai ka vlerësuar se i pari i qeverisë ndryshe ka folur e ndryshe ka vepruar me opozitën. Sipas Shalës, konsensusi i spektrit politik për dialogun do ta fuqizonte pozicionin e Kosovës në këtë proces

## BE-ja i shkruan Edita Tahirit se shkëmbimi i territoreve nuk është pjesë e agjendës së dialogut



Përfaqësuesi special i BE-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajčak, në një përgjigje që i ka kthyer Lobit Rajonal të Grave të Evropës Juglindore, i drejtuar nga Edita Tahiri, në lidhje me procesin e dialogut, ka konfirmuar se shkëmbimi i territoreve nuk është pjesë e agjendës së dialogut. "Siç e kam cekur në shumë raste, shkëmbimi i territoreve nuk është në agjendë për diskutim. Ajo që po kërkojmë është një marrëveshje që do të kontribuojë në stabilitetin rajonal, që normalizon marrëdhëniet në mes të Beogradit dhe Prishtinës", thuhet në letrën e Lajçakut drejtuar LRGEJL-së | FAQE 3

## 26 669 maturantë i nënshtrohen testit të maturës

FAQE 6



## TRUMPI PRANON NOMINIMIN NGA PARTIA REPUBLIKANE KANDIDAT PËR PRESIDENT

F. 2

## VESELI NË SHTIME DHE LIPJAN KËRKON MOBILIZIM TË STRUKTURAVE TË PDK-së

F. 5



## KOSOVA DHE ZVICRA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE GJASHTËMILIONËSHE PËR NGROHTOREN E GJAKOVËS

F. 9

## PROCEOHET KËRKESA E KOMPANISË 'KOSMOTEC FOODS' PËR INVESTIME NË KOSOVË

F. 9

## MKRS-ja INVESTON 25 MIJË EURO NË FUSHAT SPORTIVE NË KËRPIHEH

F. 18

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Trumpi pranon nominimin nga Partia Republikane kandidat për president



WASHINGTON, 28 GUSHT - Presidenti amerikan Donald Trump i cilësoi Partinë Demokratike dhe të nominuarin e saj për president, Joe Biden, "majtistë radikalë, që janë kërcënim për ëndrrën amerikane". Trumpi komentet i bëri gjatë fjalimit të tij, në mbyllje të Konventës Kombëtare Republikane. Ai ka pranuar nominimin nga Partia Republikane kandidat për rizgjedhje në postin e presidentit. Kundërkandidat i tij në zgjedhjet që do të mbahen në nëntor është Joe Biden. Trumpi, duke folur në një skenë

të madhe jashtë Shtëpisë së Bardhë, tha se Bideni do ta "shkatërrojë madhësinë amerikane" nëse zgjidhet. Trumpi tha se administrata e tij "kishte kaluar katër vjetët e fundit për ta përmirësuar dëmin që Joe Biden i shkaktoi si senator dhe nënpresident", duke shtuar se gjithçka që administrata Trump kishte arritur, "tani është në rrezik". "Demokratët nuk e shohin Amerikën si kombin më të lirë, të drejtë dhe të jashtëzakonshëm në tokë. Në vend të kësaj, ata shohin një komb të dobët që duhet të ndëshkohet për mëkatet e tij",

tha Trumpi. Ai pyeti se si kjo parti mund ta udhëheqë vendin "kur harxhon kaq shumë kohë duke e shkatërruar atë?" Duke folur për pandeminë e koronavirusit dhe çështjet racore, si dy probleme që kanë përfshirë vendin, Trumpi tha se Bideni vetëm do t'i përkeqësonte grindjet racore mbi sulmet policore ndaj amerikanëve me ngjyrë. "Këto zgjedhje do të vendosin nëse ne i mbrojmë amerikanët që zbatojnë ligjin, ose nëse ne i lëshojnë frerët ndaj anarkistëve dhe kriminelëve që kërcënojnë qytetarët tanë. Askush nuk do të jetë i sigurt në Amerikën e

Bidenit", tha Trump. Kandidati demokrat për president, Joe Biden, iu përgjigj deklaratave të Trumpit. "Kur Donald Trumpi thotë sonte që nuk do të jesh i sigurt në Amerikën e Joe Bidenit, shikoj përreth dhe pyes veten: Sa e sigurt ndihesh në Amerikën e Donald Trumpit?", ka shkruar Bideni në rrjetin social "Twitter". Trumpi, gjatë fjalimit të tij, tha se sistemi i drejtësisë duhet të mbajë përgjegjësi këdo që angazhohet për sjellje të pahijshme dhe se "rregulli i turmave" nuk duhet të lejohet kurrë. Ai nuk e përmendi Jacob

Blake, njeriun me ngjyrë që u qëllua në shpinë në Kenosha, Uiskonsin. Republikanët pretendojnë se dhuna që ka shpërthyer në Kenosha dhe disa qytete të tjera amerikane është faji i guvernatorëve dhe kryetarëve demokratë. Bideni tha për MSNBC se Trumpi po i vë "rrënjë dhunës" sepse ai e shikon atë si diçka të dobishme në aspektin politik. "Ai po derdh benzinë në zjarr", tha ai. Fushata presidenciale ka qenë kryesisht në hije të debateve për pandeminë e koronavirusit, e cila ka lënë më shumë se 180 000 amerikanë të vdekur si dhe miliona të papunë. Trumpi përsëriti pohimin e tij se Kina është fajtorë për pandeminë si dhe premtoi se do ta rindërtojë ekonominë nëse rizgjidhet. Ai tha se Shtetet e Bashkuara janë duke "kaluar këtë sfidë duke ofruar terapi për shpëtimin e jetës si dhe do të prodhojnë një vaksinë deri në fund të vitit ose, ndoshta, edhe më shpejt". Trumpi e përfundoi fjalimin duke u zotuar t'i rrisë arritjet në zhvillimin e energjisë, përparimin teknologjik dhe eksplorimin e hapësirës. Një audiencë me prani fizike e më shumë se 1 000 njerëzve, herë pas here, shpërtheu në brohoritme "Katër viteve të tjera!" dhe "USA!". Njerëzit në audiencë, gjatë fjalimit të Trumpit, nuk respektuan shumë distancën fizike ose mbajtjen e maskave të fytyrës për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit, me gjithë rekomandimet e ekspertëve shëndetësorë. (Rel)

## Qeveria ul numrin e ministrive, Kuvendi rrit numrin e nënkryetarëve

SHKUP, 28 GUSHT - Derisa përbërja e re e qeverisë do të ketë shtatë ministri më pak, apo nga 26 numri i resorëve do të ulet në 19, kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut ka propozuar që numri i nënkryetarëve të institucionit ligjvënës të rritet nga tre në pesë. Një propozim i këtillë bie ndesh me deklaratimet e të nominuarit për kryeministër, Zoran Zaev, se pushteti i ri do të angazhohet për rritjen e efikasitetit të punës së institucioneve dhe, në anën vjetër, uljen e numrit të punonjësve të administratës, përfshirë qeverinë, kuvendin dhe organet e tjera të pushtetit

lokal dhe atij qendror. Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, rritjen e numrit të nënkryetarëve e kishte arsyetuar me rregulloren mbi punën e këtij institucioni që, sipas tij, parasheh këtë numër, por edhe përfaqësimin e të gjitha partive parlamentare në kryesinë e kuvendit. Partitë, ndërkohë, kanë qëndrime të ndryshme nëse do të ketë ose jo rritje të numrit. VMRO DPMNE-ja ka kërkuar që të mos ketë më shumë se dy nënkryetarë për shkak të, siç ka thënë, "shpenzimeve të panevojshme në kohën kur vendi po përballet me pasojat e rënda ekonomike për shkak të



pandemisë". Edhe opozita shqiptare e ka vlerësuar të panevojshme rritjen e numrit të

nënkryetarëve. Po ashtu, edhe njohësit e çështjeve juridike thonë se emërimet e tilla janë të panevojshme dhe se nuk bëhen

për rritje të efikasitetit të punës, por për qëllime politike. Sipas një përlllogaritjeje, pesë nënkryetarët e Kuvendit do të kishin paga prej rreth 90 mijë denarëve apo 1 500 euro. Veç kësaj, ata do të kenë kabinete të veçanta, me të drejtë që të ketë edhe të punësuar të tjerë, si këshilltarë, sekretarë të kabinetit, si dhe shofer personal. Me propozimin e të nominuarit për kryeministër Zoran Zaev, qeveria e re nuk do t'i ketë shtatë ministri pa resorë, për funksionimin e të cilave brenda një viti për paga dhe nevoja të tjera janë shpenzuar nga rreth gjysmë milioni euro.

# BE-ja i shkruan Edita Tahirit se shkëmbimi i territoreve nuk është pjesë e agjendës së dialogut

Përfaqësuesi special i BE-së për dialogun e Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, në një përgjigje që i ka kthyer Lobit Rajonal të Grave të Evropës Juglindore, i drejtuar nga Edita Tahiri, në lidhje me procesin e dialogut, ka konfirmuar se shkëmbimi i territoreve nuk është pjesë e agjendës së dialogut. “Siç e kam cekur në shumë raste, shkëmbimi i territoreve nuk është në agjendë për diskutim. Ajo që po kërkojmë është një marrëveshje që do të kontribuojë në stabilitetin rajonal, që normalizon marrëdhëniet në mes të Beogradit dhe Prishtinës”, thuhet në letrën e Lajçakut drejtuar LRGEJL-së



**EPOKA ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 28 GUSHT** - Përfaqësuesi special i BE-së për dialogun e Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, i ka thyer përgjigje Lobit Rajonal të Grave të Evropës Juglindore të drejtuar nga Edita Tahiri në lidhje me rolin kyç që gratë kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë në ndërtimin e paqes, veçanërisht në kontekstin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë letër të Lajçakut drejtuar Komitetit Drejtues të LRGEJL-së, theksohet se dialogu në Bruksel nuk do ta ketë në agjendë temën e shkëmbimit të territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe BE-ja kërkon një

marrëveshje që do të kontribuojë në stabilitetin rajonal, t'i normalizojë marrëdhëniet në mes të Beogradit dhe Prishtinës dhe do t'u ndihmojë të ecin përpara në rrugët e tyre respektive evropiane.

Po ashtu, BE-ja siguron angazhimin për t'i respektuar çështjet gjinore të cilat do të reflektohen në marrëveshje. “Të nderuara anëtare të Komitetit Drejtues të LRGEJL, ju faleminderit për letrën tuaj në lidhje me rolin kyç që gratë kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë në ndërtimin e paqes, veçanërisht në kontekstin e dialogut në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Bashkimi Evropian (BE) është i përkushtuar të zbatojë dhe të nxisë nisma, politika dhe

programe në përputhje me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR). Siç e dini, kjo rezolutë i identifikon gratë në një shkallë të lartë si aktore të domosdoshme në ndërtim të paqes dhe ndërmjetësim në konflikte dhe bën thirrje për përfshirjen e tyre të shtuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes”, thuhet në këtë letër të Lajçakut. Ai ka theksuar në këtë letër se mandati i tij si kryetar i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së e ka fuqizuar bindjen e tij se barazia gjinore dhe përfshirja e grave në të gjitha fazat e ndërtimit të paqes janë kritike për të arritur paqe të qëndrueshme. “Isha i lumtur që kisha mundësinë ta theksoj edhe një herë rolin e grave në proceset e paqes gjatë kryesimit

të Slovakisë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) më 2019. Një nga arritjet e mia kryesore si kryesues i OSCE-së ishte lansimi i udhëzuesit për përfshirjen e grave dhe proceset efektive të paqes në Këshillin Ministror në Bratisllavë. Falë grave si ju dhe dy përfaqësueseve të Larta/Nënkryetareve të BE-së ne kemi pasur mundësi të arrijmë përparim domethënës në dhjetëra fusha të dialogut. Shumë gra të tjera kanë kontribuar në këtë përpjekje përgjatë viteve, duke përfshirë negociatorët e larta për BE-në, Prishtinën dhe Beogradin. Pres me padurim kontributin që do të vazhdojnë ta japin gratë në këtë proces”, thuhet në këtë letër.

Lajçaku në këtë letër ka theksuar se: “Ekipi im dhe unë do të vazhdojmë së integruari një dimension gjinor në përpjekjet tona për t'iu ndihmuar Beogradit dhe Prishtinës të arrijnë një marrëveshje të përgjithshme dhe ligjërishit detyruese që i rregullon të gjitha çështjet e jashtëzakonshme mes tyre. Siç e kam cekur në shumë raste, shkëmbimi i territoreve nuk është në agjendë për diskutim. Ajo që po kërkojmë është një marrëveshje që do të kontribuojë në stabilitetin rajonal, që normalizon marrëdhëniet në mes të Beogradit dhe Prishtinës dhe do t'iu ndihmojë të ecin përpara në rrugët respektive evropiane”, thuhet në këtë letër të Lajçakut dërguar si përgjigje LRGEJL-së.

## Në vendbanimet me shumicë serbe viti shkollor fillon më 1 shtator

**PRISHTINË, 28 GUSHT** - Në vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë mësimi në shkolla do të fillojë më 1 shtator, në përputhje me planin dhe programin e Ministrisë së Arsimit të Serbisë, por në kundërshtim me vendimin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës, për ta shtyrë deri më 14 shtator fillimin e vitit shkollor. Këtë lajm e konfirmoi për “Radio Evropa e Lirë”, Jasmina Dediq, drejtuese e Administratës së Shkollave në Kosovë, e cila funksionon në kuadër të sistemit serb. “Ende nuk e dimë nëse do të zhvillohet në internet apo nëse klasat do të kombinohen, kjo varet nga situata epidemiologjike”, ka thënë Dediq. Nga ana tjetër, zëvendësministri i Arsimit dhe

Shkencës, Xhavit Rexha, ka thënë për “Radio Evropa e Lirë” se vendimi i Qeverisë së Kosovës për ta shtyrë fillimin e vitit shkollor vlen për të gjitha komunitetet në Kosovë dhe të gjitha institucionet arsimore. Institucionet arsimore që funksionojnë sipas sistemit serb në Kosovë, në periudhën e kaluar, për shkak të epidemisë së koronavirusit, ishin detyruar ta harmonizonin punën e tyre me vendimet e Qeverisë së Kosovës.

Pas shfaqjes së rasteve të para me koronavirus, Qeveria e Kosovës vendosi masa të ashpra për ta parandaluar përhapjen e pandemisë, kështu që më 12 mars të gjitha institucionet arsimore u mbyllën. Sidoqoftë, disa shkolla në gjuhën serbe nuk pranuan ta zbatojnë këtë



vendim, duke argumentuar se ato respektojnë vendimet e qeverisë serbe. Në të njëjtën ditë, shefi i Zyrës

për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, pati njoftuar se procesi mësimor në shkollat e vendbanimeve serbe

në Kosovë do të ndërpritet më 16 mars. Pastaj, viti shkollor 2019/2020 u përmbyll përmes mësimi në distancë.



Flet për “Epokën e re”, Behxhet Shala

# LDK-ja E KA MONOPOLIZUAR PROCESIN E DIALOGUT

Analisti politik Behxhet Shala ka thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e ka monopolizuar procesin e dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se duke pasur dy postet kryesore që kanë të bëjnë me këtë proces, LDK-ja ia ka dhënë vetes të drejtën për ta përfaqësuar Kosovën në dialogun e Brukselit dhe të Uashingtonit. Shala ka kritikuar qasjen e kryeministrit në raport me partitë opozitare në këtë proces. Ai ka vlerësuar se i pari i qeverisë ndryshe ka folur e ndryshe ka vepruar me opozitën. Sipas Shalës, konsensusi i spektrit politik për dialogun do ta fuqizonte pozicionin e Kosovës në këtë proces

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 GUSHT - Analisti politik Behxhet Shala ka vlerësuar se partia kryesore e koalicionit qeverisës, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e ka monopolizuar procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka deklaruar se nuk është dashur që dy pozitat kryesore në dialog t'i marrë kjo parti.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Shala ka thënë se LDK-ja e ka marrë barrën kryesore në këtë proces.

“Deshëm apo nuk deshëm ta pranojmë, procesi i negociatave është monopolizuar dhe privatizuar nga LDK-ja, sepse dy personat kyçë në bisedimet me Serbinë janë nga kjo parti. Pra, ata nuk janë as nga partnerët e tjerë të koalicionit qeverisës e as nga opozita. Kjo nënkupton se barrën kryesore në këto bisedime e ka LDK-ja, apo të drejtën për ta përfaqësuar Kosovën në dialog LDK-ja ia ka dhënë vetes”, ka thënë Shala. Ai ka kritikuar qasjen e kryeministrit në raport me

partitë opozitare në këtë proces. Shala ka vlerësuar se i pari i qeverisë ndryshe ka folur e ndryshe ka vepruar me opozitën. “Qasja e kryeministrit ndaj opozitës për këtë proces nuk ka qenë e duhur, sepse ai publikisht ka deklaruar shumë gjëra, por në praktikë nuk i ka bërë, ose i ka bërë me shumë vonesë. Pra, kryeministri në këtë drejtim nuk ka qenë në rregull”, është shprehur ai. Sipas Shalës, refuzimi i opozitës për të marrë pjesë në takimin e Uashingtonit është në përputhje me mandatin e

saj opozitar. “Çdo gjë është bërë me vonesë nga ana e qeverisë në këtë drejtim. Më tepër ka pasur deklarata publike që do të konsultohet opozita, mirëpo në praktikë është vepruar ndryshe. Mendoj se qëndrimi i partive opozitare është në përputhje me mandatin që kanë partitë opozitare”, ka thënë ai.

Shala ka deklaruar se konsensusi i spektrit politik për dialogun do ta fuqizonte pozicionin e Kosovës në këtë proces. “Mendoj se po ta kishin një qëndrim konsensual në këtë takim do të ishim më të fortë, më bindës, më kredibilë dhe natyrisht se do të na merrnin më seriozisht. Kështu, nëse partitë opozitare janë jashtë lojës, pra jashtë bisedimeve, atëherë është joserioze të mendohet se Avdullah Hoti do të mund të bëjë diçka. Duke i lënë anash 53 deputetë shqiptarë, kryeministri nuk do të mund të marrë ndonjë vendim i cili do

të kishte një interes strategjik apo përcaktues për të ardhmen e Kosovës”, ka thënë Shala.

**“Epoka e re”:** Z. Shala, opozita ka refuzuar pjesëmarrjen në delegacionin e kryeministrit për takimin e Uashingtonit. Si e keni parë këtë qëndrim të LV-së dhe të PDK-së?

**Shala:** Qysh në fillim është bërë një gabim kur është vendosur që ekipit negociator t'i prijë kryeministri Hoti, pastaj edhe koordinatori shtetëror për dialog Skender Hyseni, i cili është gjithashtu zyrtar i LDK-së. Kjo nënkupton se LDK-ja e ka monopolizuar procesin negociator. Siç e dimë, fillimisht edhe përfaqësuesi i AAK-së në këtë proces, Selim Selimi, ka qenë i injoruar, por me këmbënguljen e Ramush Haradinajt ai është bërë pjesë e delegacionit të Avdullah Hotit. Natyrisht as në delegacionin e Serbisë nuk ka përfaqësues të opozitës në bisedime. Pra, deri më tani Brukseli dhe



Uashingtoni nuk i kanë ftuar të tjerët, por i kanë ftuar ekskluzivisht kryeministrin Avdullah Hoti dhe Skender Hysenin. Opozita e ka një qëndrim që i takon pozicionit opozitar për këtë proces. PDK-ja po e pranon arritjen e marrëveshjes me kushte të caktuara, ku ka përmendur rrethanat në të cilat do ta pranonte marrëveshjen. Ndërsa LV-ja e refuzon këtë proces për faktin se po e konsideron qeverinë Hoti ilegjitime dhe nuk po e pranon Avdullah Hotin përfaqësues i Kosovës në bisedime me Serbinë, as në Bruksel dhe as në Uashington.

**“Epoka e re”:** A është e domosdoshme pjesëmarrja e opozitës në këtë takim?

**Shala:** Prania e opozitës nuk është domosdoshmërisht e nevojshme gjatë bisedimeve, por në konsultime ka qenë e domosdoshme. Mirëpo, çdo gjë është bërë me vonesë nga ana e qeverisë në këtë drejtim. Më tepër ka pasur deklarata publike që do të konsultohet opozita, mirëpo në praktikë është vepruar ndryshe. Mendoj se qëndrimi i partive opozitare është në përputhje me mandatin që kanë partitë opozitare.

Qysh në fillim është bërë një gabim kur është vendosur që ekipit negociator t'i prijë kryeministri Hoti, pastaj edhe koordinatori shtetëror për dialog Skender Hyseni, i cili është gjithashtu zyrtar i LDK-së. Kjo nënkupton se LDK-ja e ka monopolizuar procesin negociator. Siç e dimë, fillimisht edhe përfaqësuesi i AAK-së në këtë proces, Selim Selimi, ka qenë i injoruar, por me këmbënguljen e Ramush Haradinajt ai është bërë pjesë e delegacionit të Avdullah Hotit

**“Epoka e re”:** Pra, sipas jush, qasja e kryeministri nuk ka qenë e duhura ndaj opozitës për këtë proces?

**Shala:** Qasja e kryeministrit ndaj opozitës për këtë proces nuk ka qenë e duhura sepse ai publikisht ka deklaruar shumë gjëra, por në praktikë nuk i ka bërë, ose i ka bërë më shumë vonesë. Pra, kryeministri në këtë drejtim nuk ka qenë në rregull. Ashtu siç thashë më parë, deshëm apo nuk deshëm ta pranojmë, procesi i negociatave është monopolizuar dhe privatizuar nga LDK-ja, sepse dy personat kyçë në bisedimet me Serbinë janë nga kjo parti. Pra, ata nuk

janë as nga partnerët e tjerë të koalicionit qeverisës e as nga opozita. Kjo nënkupton se barrën kryesore në këto bisedime e ka LDK-ja, apo të drejtën për ta përfaqësuar Kosovën në dialog LDK-ja ia ka dhënë vetes.

**“Epoka e re”:** Do të ndryshonte diçka në këtë takim me pjesëmarrjen e opozitës?

**Shala:** Mendoj se po ta kishin një qëndrim konsensual në këtë takim do të ishim më të fortë, më bindës, më kredibilë dhe natyrisht se do të na merrnin më seriozisht. Kështu, nëse partitë opozitare janë jashtë loje, pra jashtë

bisedimeve, atëherë është joserioze të mendohet se Avdullah Hoti do të mund të bëjë diçka. Duke i lënë anash 53 deputetë shqiptarë, kryeministri nuk do të mund të marrë ndonjë vendim i cili do të kishte një interes strategjik apo përcaktues për të ardhmen e Kosovës. Është joserioze të mendohet se kjo përbërje e qeverisë ta nënshkruajë një marrëveshje e cila do të ishte e duhura për Kosovën.

**“Epoka e re”:** Subjektet politike dhe qeveria kanë pritje të ndryshme nga ky takim. Çka mendoni se do të diskutohet në takimin e Uashingtonit?

**Shala:** As qeveria dhe as Vetëvendosja nuk e dinë se çka do të bisedohet dhe çka do të vendoset në këtë takim. Në kohën kur në ShBA po zhvillohet fushata për zgjedhjet presidenciale, të shkohet me pretendimin se do të arrihet një marrëveshje finale, është joserioze. Nuk pres se do të ketë diçka konkrete nga ky takim. Po edhe nëse do të ketë diçka, ajo do të jetë e imponuar. Është e pamundur, joserioze dhe e papranueshme që të arrihet çfarëdo marrëveshje duke lënë anash 53 deputetë shqiptarë.

## Veseli në Shtime dhe Lipjan kërkon mobilizim të strukturave të PDK-së



Shtime, 28 gusht - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm, Uran Ismaili dhe sekretari elektoral Betim

Gjoshi, ka vizituar strukturat e partisë në Shtime dhe Lipjan. Gjatë kësaj vizite ai ka përgëzuar punën e madhe që po bëjnë këto dy degë për zhvillimin e reformave për-

brenda tyre. Kryetari Veseli ka theksuar edhe një herë nevojën e jashtëzakonshme për mobilizim të strukturave të PDK-së në të mirë të qytetarëve, karshi sfidave nëpër të

cilat po kalon vendi. Kryetari i degës në Shtime dhe ai në Lipjan, Rahman Jakupi dhe Hyzer Rizani, duke falënderuar kryetarin Veseli dhe kryesinë qendrore për

mbështetjen, kanë shprehur gatishmërinë dhe angazhimin e tyre të madh për realizimin e politikave partiake në interes për qytetarin dhe shtetin.

(Q. Rama)

# Kosova dhe Zvicra nënshkruajnë marrëveshje 6-milionëshe për ngrohtoren e Gjakovës

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

**GJAKOVË, 28 GUSHT** - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, së bashku me ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly dhe kryetarin e Gjakovës, Ardian Gjini, kanë nënshkruar marrëveshje për mbështetje në projektin për përmirësimin e performancës së ngrohtores së re në Gjakovë.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje ka për qëllim rehabilitimin e rrjetit të ngrohtores, përmirësimin e efikasitetit energjetik të shpërndarjes, gjithashtu do ta bëjë ofrimin e shërbimit të ngrohjes dhe ujit të ngrohtë për Spitalin e Gjakovës "Isa Grezda", si dhe përmes këtij projekti do të bëhet kyçja në

rrjetin e ngrohjes për institucionet publike. "Është një nga projektet më të rëndësishme në Kosovë i cili do të financohet nga qeveria zvicerane me 5.5 milionë si dhe nga Komuna e Gjakovës me shumën 500 mijë euro, prandaj jemi falënderues Qeverisë së Zvicrës për këtë projekt si dhe për projekte të tjera të cilat janë në realizim e sipër", ka thënë ministri Kuçi.

Ndërsa ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly, u shpreh se ky është një projekt i madh, i rëndësishëm së shumfışhtë që ka efekt pozitiv në reduktimin e emetimit të CO2 gjë që do të ndikojë në mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Komunës së Gjakovës duke përmirësuar kualitetin e ajrit. "Është kënaqësi të jem këtu me ju, në



eventin e parë si ambasador i Zvicrës në Kosovë. Është projekt shumë i mirë dhe është projekt shembull që duhet ndjekur", ka thënë ambasadori Kolly.

Ndërkaq kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se ngrohtorja e re e Gjakovës me biomasë është një ndër projektet më të mira që kanë

ndodhur në Kosovë në fushën e energjisë, përmes të cilit do të zgjerohet rrjeti në veri të qytetit si dhe rrjeti në Spitalin e Gjakovës "Isa Grezda".

## Ministria e Jashtme dënon aktin e djegies së flamurit grek në Prishtinë

**PRISHTINË, 28 GUSHT (ER)** - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, Meliza Haradinaj-Stublla, ka dënuar djegien e një flamuri grek nga tifozët vendës të futbollit, pasi Klubi Gjilani humbi një ndeshje kualifikuese të Ligës së Evropës kundër një skuadre nga Qiproja.

Tifozët e dogjën flamurin të enjten në Prishtinë, kur Klubi Gjilani humbi ndaj APOEL Nicosia 2-0 dhe u eliminua nga gara. "Dënojmë fuqishëm çdo lloj akti fyes të simbolit kombëtar të cilitdo shtet, në rastin konkret të Greqisë. Kosova dhe Greqia kanë vendosur dialog praktik, kanë zyra ndërlidhëse në kryeqendrat

e tyre dhe të dyja palët punojnë për ta thelluar dialogun edhe më tej", ka thënë përmes një deklarate ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë, Meliza Haradinaj-Stublla, duke e konsideruar të papranueshëm aktin e ulët të disa tifozëve.

Haradinaj-Stublla gjithashtu u kërkoi autoriteteve të zbatimit të ligjit "të reagojnë shpejt dhe t'i marrin para drejtësisë autorët e këtij akti", të cilin ajo e quajti "një veprim të turpshëm në kundërshtim të plotë me idetë e përqafuara nga populli i Kosovës si një shoqëri demokratike". Greqia nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës të shpallur në vitin 2008.



## 26 669 maturantë i nënshtrohen testit të maturës

Prishtinë, 28 gusht (ER) - Komisioni Shtetëror i Maturës (KShM) ka bërë me dije se 26 669 maturantë sot (e shtunë) do t'i nënshtrohen testit të maturës, i cili do të fillojë në orën 10:00 dhe do të përfundojë në orën 12:30. Testi i maturës do të organizohet në 184 qendra të testimit, në 30 komuna të Kosovës dhe për mbarëvajtjen e procesit janë angazhuar 2 568 administrues, 570 komisionarë, 570 mbikëqyrës dhe nga tre mësimdhënës në secilën qendër.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, testi i maturës do të organizohet duke respektuar masat mbrojtëse të rekomanduara nga institucionet e shëndetësisë, ku në secilën

klasë numri maksimal do të jetë 12 nxënës. "Maturantët duhet të arrijnë në oborrin e qendrës së testimit nga ora 8:30 deri në orën 9:00. Nga ora 9:00 deri në 9:30 ata do të sistemohen në klasa dhe, pas vendosjes në klasa, deri në orën 10:00 do të bëhet ofrimi i udhëzimeve rreth testit dhe ofrimi i fletëpërgjigjeve nga ana e administruesve" është bërë me dije në njoftimin për media të KShM-së.

Në njoftim theksohet se në ditën e testimit u ndalohet hyrja nëpër qendra të testimit të gjithë personave që nuk janë pjesë e këtij procesi. Ndërsa mediat mund të kenë qasje nëpër qendra të testimit, në koordinim me komisionin e qendrës së testimit, deri në orën 09:30.



Raporti 24-orësh i IKShPK-së: 154 të shëruar, një i vdekur dhe 119 raste të reja me Covid-19

## Bie numri i vdekjeve nga Covidi në Kosovë

Në 24 orët e fundit në Kosovë është regjistruar vetëm një rast i vdekjes me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se me këtë rast numri i përgjithshëm i vdekjeve me Covid ka shkuar në 499. Ky institut ka theksuar se brenda 24 orëve janë paraqitur edhe 119 raste të reja me virusin "Korona". "Numri total i rasteve pozitive është 13 100 raste nga 49 757 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 499 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 154 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 9 239 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 362", ka njoftuar IKShPK-ja



**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë shëruar 154 persona dhe janë paraqitur 119 raste të reja me Covid-19. Po ashtu, ku institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore ka ndërruar jetë një person si pasojë e infektimit me koronavirus. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR dhe në labora-

torët private, janë testuar gjithsej 480 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 119 raste pozitive. Brenda 24 orëve është raportuar 1 rast i vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 13 100 raste nga 49 757 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 499 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 154 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 9 239 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 362", ka njoftuar IKShPK-ja,

duke treguar rastet e reja sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 36 raste, komuna Gjilan 14 raste, komuna Vushtrri 10 raste, komuna Mitrovicë 9 raste, komuna Skenderaj 9 raste, komuna Podujevë 8 raste, komuna Drenas 7 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Obiliq 2 raste, komuna Pejë 2 raste dhe me nga një rast komunat Gjakovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Shtime, Suharekë dhe Viti", ka njoftuar IKShPK-ja.

### AKK-ja nuk gjen parregullsi në laboratorët privatë që kryejnë teste serologjike

Autoritetit Kosovar i Konkurrencës (AKK) nuk ka gjetur ndonjë parregullsi në laboratorët privatë në lidhje me testimet për Covid. Në konferencën për media lidhur me monitorimin e çmimeve për testimet për virusin SARS-CoV-2, Muhamet Krasniqi, anëtar i komisionit për monitorim, ka theksuar se nga 118 laboratorë të licencuar, bazuar në infor-

matat e AKK-së, nuk ka arritur të gjejë ndonjë shërbim që bie ndesh me ligjet në fuqi. "Është një treg që po funksionon mirë, treg i liberalizuar", ka thënë Krasniqi. Ndërsa Rizah Arifi, kryesues i grupit të punës për monitorimin e laboratorëve, ka thënë se AKK-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë nga qytetarët për ndonjë parregullsi për këtë çështje.

### Zemaj shpërndan maska në qytetin e Podujevës

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka njoftuar të premten se së bashku me disa të rinj ka bërë shpërndarjen e maskave mbrojtëse kundër Covidit në qytetin e Podujevës. "Shpërndarja e maskave gjatë ditës në qytetin e Podujevës bashkë me të rinjtë e organizatës 'PEN' është pjesë e projektit të radhës, 'Be with us', projekt ky i mbështetur edhe nga

Ambasada e Japonisë në Kosovë dhe UNICEF-i. Si ministër i Shëndetësisë dua t'i falënderoj edhe një herë sot Murat Sahin, drejtor i UNICEF-it, Mitsunori Ogasawara, ambasador i Japonisë në Kosovë, por edhe gjithë donatorët e tjerë që po e mbështesin Kosovën në këtë rrugëtim", ka thënë Zemaj, duke treguar edhe për donacionet e tjera që do të pranojnë nga UNICEF-i dhe Japonia. "Tashmë kemi të konfir-

muar se shumë shpejt do të marrin edhe një mbështetje tjetër nga UNICEF-i e që ka të bëjë me pajisje mbrojtëse profesionale me mbi 30 tonë si dhe nga Japonia ndihmën e radhës me medikamente për Sars Covid-19. Gjatë aktivitetit të sotëm ishim të shoqëruar edhe nga ministrja e Kulturës, Vlora Dumoshi, nënkryetari i Podujevës, Nexhmi Rudarin si dhe Bujar Fejzullahu, drejtor i 'PEN'-it", ka deklaruar Zemaj.




## Hoti diskuton me partnerët ndërkombëtarë për gjendjen epidemiologjike në vend

**EPOKA  
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 GUSHT - Në funksion të koordinimit me partnerët tanë ndërkombëtarë, sa i përket situatës epidemiologjike si pasojë e pandemisë Covid-19, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka mbajtur të premten një takim virtual me ambasadorë të akredituar në vendin tonë dhe me drejtues institucionesh partnere ndërkombëtare. Në këtë takim morën pjesë ambasadorët Philip S. Kosnett (SHBA), Nicholas Abbott (Mbretëri e Bashkuar), Jorn

Rohde (Gjermani), Marie-Christine Butel (Francë), Nicola Orlando (Itali), Natacha Gomes (Luksemburg), zëvendësambasadorja e Norvegjisë Jenny Stenberg Sorvold, drejtori i Bankës Botërore për Kosovën, Massimiliano Paolucci, koordinatorja për Zhvillim e Agjencie të Kombeve të Bashkuara, Ulrika Richardson, zëvendëshefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Riccardo Serri, shefi i Seksionit të Bashkëpunimit të BE-së me Kosovën, Luigi Brusa dhe zëvendëskryesuesja e Bashkëpunimit e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Hillen Francke.



Kryeministri Hoti paraqiti situatën epidemiologjike dhe veprimet që po ndërmarrin institucionet për t'i rritur kapacitetet e menaxhimit dhe

parandalimit të përhapjes së pandemisë Covid-19. Po ashtu, ai i falënderoi vendet dhe institucionet partnere për ndihmën e vazhdueshme që i kanë dhënë

Kosovës për përballimin e kësaj pandemie. Pjesëmarrësit në diskutim u pajtuan që të shtohet koordinimi i punës së institucioneve të Kosovës me partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht sa iu përket nevojave që ka sistemi ynë shëndetësor për ta përballuar situatën epidemiologjike gjatë periudhës në vazhdim. Gjithashtu, u arrit pajtimi që të formalizohet një mekanizëm i përbashkët i shkëmbimit të informacionit të analizës për situatën epidemiologjike, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta.

## Bordi i përkohshëm i drejtorëve të KEK-ut propozon testimin e të gjithë stafit

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Bordi i përkohshëm i drejtorëve të KEK-ut në mbledhjen e mbajtur të radhës ka marrë një sërë vendimesh me rëndësi për korporatën.

Në funksion të menaxhimit të vazhdueshëm të pandemisë Covid-19, bordi i përkohshëm i drejtorëve të KEK-ut ka udhëzuar menaxhmentin që t'i fillojë menjëherë procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative për testimin e të gjithë stafit të korporatës me testim serologjik dhe për këtë ka ndarë edhe mjetet e nevojshme financiare.

Bordi i përkohshëm i drejtorëve të KEK-ut ka shqyrtuar dhe miratuar raportet e performancës

gjashtëmujore dhe atë të pasqyrave financiare në korporatë deri më 30.06.2020.

Bordi ka kërkuar mobilizim shtesë të menaxhmentit për adresimin e gjetjeve të auditorit të jashtëm dhe atij të brendshëm, gjithnjë në funksion të përmirësimit të performancës operative e financiare dhe në instalimin e kontrolleve të mirëfillta të brendshme.

Në fund, bordi i përkohshëm i drejtorëve të KEK-ut ka inkurajuar menaxhmentin që t'i vazhdojë përgatitjet për jetësimin e një studimi të mirëfilltë të fizibilitetit për Termocentralin "Kosova A" dhe hartimin e një strategjie zhvillimore të korporatës.



## Klubi i Prodhuesve arrin memorandum bashkëpunimi me Rrjetin Evropian të Ndërmarrjeve

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim t'i mbështesë anëtarët e Klubit të Prodhuesve me shërbime profesionale individuale dhe këshilluese në lidhje me punën e Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Klubi i Prodhuesve të premten ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Rrjetin Evropian të Ndërmarrjeve, i përfaqësuar nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës - STIKK, për zhvillimin dhe implementimin e disa projekteve specifike përbrenda programit COSME.

Në njoftimin për media thuhet se ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim t'i mbështesë anëtarët e Klubit të Prodhuesve me shërbime profesionale individuale dhe

këshilluese në lidhje me punën e Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve, por edhe ofrimin e shërbimeve të tjera brenda platformës se tyre. "Pjesë e këtij memorandum bashkëpunimi është edhe mbështetja dhe lehtësimi i anëtarëve të Klubit të Prodhuesve në aplikimin drejt thirrjeve të ndryshme të granteve të programit COSME dhe mundësive të tjera si ndërkombëtarizimi, inovacioni, promovimi i eksportit, teknologjia dhe transferimi i njohurive etj", thuhet në njoftimin e Klubit të Prodhuesve.



## Qeveria e bën të pavarur Inspektoratin e Punës

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e radhës ka miratuar projektligje, rregullore dhe vendime nga fusha e përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore. Qeveria në mbledhjen e vet ka bërë ndryshim edhe në Projektligjin për Inspektoratin e Punës.

Projektligji përkufizon Inspektoratin e Punës, si organ i pavarur dhe ekzekutiv i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me mandat që t'i mbikëqyrë dispozitat ligjore nga marrëdhënia e punës.

Çështjet kryesore të trajtuara në projektligj janë: Mandati i Inspektoratit të Punës;

Struktura organizative; Statusi i të punësuarve, duke përfshirë kushtet dhe kriteret profesionale; Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv; Kompetencat e inspektorëve të punës; Procedurën e inspektimeve, duke përfshirë edhe llojet e inspektimeve; Parandalimin e konfliktit të interesit; Të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit gjatë inspektimit; Hetimet e aksidenteve në punë; Gjobat; Procedurat administrative dhe ato të kundërvajtjes; Buxhetin e Inspektoratit të Punës; Ndërlidhjen ndërmjet Inspektoratit të Punës dhe Ministrisë.

Inspektoratin e Punës e drejton Ekrem Kastrati.



# Procedohet kërkesa e kompanisë ‘Kosmote Foods’ për investime në Kosovë



PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Komisioni Ndërmëtor për Investime Strategjike, i kryesuar nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka mbajtur takimin e radhës në të cilin ka shqyrtuar dhe miratuar disa kërkesa të investitorëve

strategjikë. Komisioni në fjalë ka proceduar edhe një kompani për ta marrë statusin e investitorit strategjik. Me 5 vota për dhe 2 kundër është miratuar për procedim më tutje në zyrën e kryeministrit kërkesa e kompanisë “Kosmote

Foods” për investime në Kosovë. Vendimi është marrë pas interpretimit ligjor nga Zyra Ligjore e MTI-së, e cila ka konstatuar se komisioni mund t'i vazhdojë procedurat. Ministri Krasniqi, në cilësinë e kryesuesit, ka theksuar se janë

shtuar edhe katër investitorë potencialë për investime strategjike, të cilët i plotësojnë kushtet teknike, të kërkuara në bazë të Ligjit për Investime Strategjike. Ministri Krasniqi ka pohuar se kërkesat e investitorëve

potencialë do të shqyrtohen javën e ardhshme, duke theksuar se shifra e investimeve të tyre arrin në 300 milionë euro. Po ashtu, u votua unanimisht Grupi Operacional për shqyrtimin e kërkesës së kompanisë “MOXIKO-LUMA KOSOVO LLC”.

## Të dielën nuk do të ketë rrymë 10 orë në një pjesë të Prishtinës



PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Këtë të diel rreth 25 mijë konsumatorë, duke përfshirë Prishtinën dhe një pjesë të Fushë-Kosovës, do të mbesin pa rrymë për disa orë. Për ta mundur realizimin e punimeve në kuadër të projekteve zhvillimore, KOSTT-i ka njoftuar se më 30 gusht, nga ora 04:00 deri në orën 14:00, do të bëhet shkyçja e transformatorit energjetik TR1 110/35/10 kV në Nënstacionin 110/35/10 kV Prishtina 1. “Shkyçja është e nevojshme për krijimin e kushteve të sigurisë në punë gjatë kyçjes së trafofushës së re 10 kV në

kuadër të projektit për montimin e kthinës së re dhe kablllove 10 kV në transformatorin TR 1. Gjatë kohës së lartcekur, qytetarët/institucionet që furnizohen nga ky transformator (ana 10 kV) do të mbesin pa furnizim me energji elektrike (reduktimi i parashikuar 12 MW). Punimet në fjalë do të ndikojnë në rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së operimit të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës. KOSTT sh.a kërkon mirëkuptim nga qytetarët”, thuhet në njoftimin e KOSTT-it.

## Disa lagje në kryeqytet të shtunën nuk do të kenë ujë të pijshëm

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Kompania rajonale e ujësjellësit “Prishtina” ka njoftuar se në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit në tërë zonën e shërbimit, të shtunën, më 29 gusht, ka planifikuar punime teknike në gypin e ujit nga çeliku fi 600 mm që vjen nga Badoci në rezervuarin e Mirditës. Si rrjedhojë, të shtunën, duke

filluar nga ora 08:00 - 20:00, nuk do të kenë ujë të pijshëm këto zona: Komuna e Graçanicës, Hajvalia, Veterniku, Matiqani (konsumatorët që janë të kyçur në gypin e çelikut), zona qendër e lagjes Bregu i Diellit, një pjesë e Aktashit dhe një pjesë e Lagjes së Muhaxhirëve në Prishtinë. “Janë bërë të gjitha parapërgatitjet nga operatori ekonomik, në koordinim me

drejtorinë teknike dhe ekipet e mirëmbajtjes e operimit, andaj janë të gatshëm për intervenim të pandërprerë në bashkëpunim me operatorin ekonomik. Për shkak se ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm do të jetë mbi 6 orë, autocisternat do të jenë në terren për furnizim me ujë për konsumatorët”, thuhet në njoftim e kompanisë rajonale të ujësjellësit “Prishtina”.



## Komuna e Fushë-Kosovës dhe MAPL-ja nënshkruajnë marrëveshje mirëkuptimi

FUSHË-KOSOVË, 28 GUSHT (ER) - Pas dorëzimit të projektpropozimit për projektin "Asfaltimi i rrugës Pomozotin - Fushë-Kosovë", në thirrjen e hapur nga Ministria e Administrimit dhe Pushteti Lokal (MAPL) dhe pas verifikimit nga ana e komisionit përkatës, Komuna e Fushë-Kosovës i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe ka fituar të drejtën për grant në mesin e dhjetë komunave të Republikës së

Kosovës. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me ministrin e Ministrisë së Pushtetit Lokal (MAPL), Goran Rakiq. Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi i infrastrukturës socio-ekonomike dhe vlera totale e tij është 60 mijë euro. Nga buxheti i MPL-së për investime kapitale janë ndarë 50 mijë euro për këtë projekt,

me bashkëfinancim nga komuna në vlerë prej 10 000 eurosh. Ministri Rakiq ka uruar kryetarët e komunave për mjetet e fituara dhe ka theksuar se ministria që drejton do të vazhdojë që në periudhën e ardhshme të sigurojë mbështetje dhe ndihmë maksimale për të gjitha komunat, duke përmirësuar infrastrukturën për të cilën janë dhënë mjetet.



## Ndërtohen trotuare në Lupç dhe Batllavë

PODUJEVË, 28 GUSHT (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve infrastrukturore në Komunën e Podujevës, drejt finalizimit janë edhe trotuaret në fshatrat Lupç i Poshtëm dhe Batllavë. Për t'i përcjellë nga afër punimet në këto fshatra, ato i ka vizituar nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari,

së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Faik Muçiqi. Me këtë rast nënkryetari Rudari tha se realizimi i këtyre projekteve ndikon në rritjen e sigurisë për banorët e këtyre fshatrave. "Kompletimi i infrastrukturës rrugore në këto fshatra ka për qëllim

rritjen e sigurisë për banorët e sidomos për nënësit, sepse në të dy rastet trotuaret po ndërtohen në rrugët që janë në afërsi të shkollave", ka thënë nënkryetari Rudari. Punimet po zhvillohen në segmentin e rrugës Podujevë - Batllavë, në gjatësi 800 metra dhe në Lupç të Poshtëm, 1.2 km.

## Shpërndahen 8 400 maska për personelin shëndetësor në Prishtinë

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se 8 400 maska kirurgjikale për mbrojtje kundër Covid-19 janë shpërndarë për personelin shëndetësor të Qendrave të Mjekësisë

Familjare në Prishtinë. "Falënderojmë LDS Charities për donacionin prej 24 000 maskave mbrojtëse dhe mbështetjen e vazhdueshme për Komunën e Prishtinës", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



## Kamenica mbështet organizatën 'HandiKOS'

KAMENICË, 28 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka pritur të premtën në takim udhëheqësen e organizatës joqeveritare "HandiKOS" në këtë komunë, Hyrmete Morina. Në këtë takim Kastrati ka nënshkruar kontratën për ndarjen e mjeteve financiare për organizatën "HandiKOS", për projektin për përkrahjen e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta, që ofrohen nga kjo organizatë në Kamenicë.

Kastrati ka thënë se kjo organizatë ndihmon shumë personat me aftësi të kufizuara dhe do të ketë përkrahje brenda mundësive që i ka komuna. "Së bashku me zonjën Hyrmete Morina, udhëheqëse në organizatën joqeveritare 'HandiKOS' në Kamenicë, sot nënshkruam kontratën për projektin



për përkrahjen e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta që ofrohen nga 'HandiKOS' në Kamenicë. Ndonëse përkrahja për personat me nevoja të veçanta nuk është e mjaftueshme, marrë parasysh kërkesat e tyre, ne si komunë në vazhdimësi u kemi ofruar mbështetje me mundësitë të cilat i kemi. Personat me nevoja të veçanta janë pjesë e shoqërisë sonë dhe duhet të trajtohen dinjitetshëm", ka thënë Kastrati.

Ndërsa udhëheqësja e kësaj organizate, Hyrmete Morina, ka falënderuar Kastratin për ndarjen e këtyre mjeteve. "Ju falënderoj për përkrahjen e vazhdueshme kryetar. Ne kemi nevoja të shumta në organizatën tonë. Këto mjete do të shpërndahen për aktivitete të ndryshme", ka thënë ajo.

# ZOTËRI MARTY, LUFTËTARËT E UÇK-së NUK ISHIN UFO, POR BIJTË MË TË DENJË TË POPULLIT SHQIPTAR (39)



Shkruan: Kudusi LAMA

Dhe që në përfundim të luftës UÇK-ja do ta merrte kontrollin e vendit, konsiderohet plotësisht normale. Anormale do të ishte sikur ajo t'ua linte atë serbëve sipas dëshirës që keni ju. Por atë kontroll nuk kishin pse e merrnin që të "mund të kryenin trafikime dhe veprimtari të ndryshme kontrabande", pasi kishin luftuar për liri e jo për banditizëm, siç keni dëshirë të jetë e vërtetë ju dhe serbët. Sipas idesë tuaj, unë e kuptoj shumë mirë, në gjithë përmbajtjen e raportit, se në Kosovë nuk mund të ketë siguri pa serbët. Këtë e kanë thënë serbët vazhdimisht, nuk jeni ju i pari dhe nuk po thoni diçka të re e të panjohur për shqiptarët.

Dhe ta dini mirë, se në vitin 1999, pas përfundimit të luftës, UÇK-ja e kontrollonte gjithë Kosovën me të drejtën e qenies ushtri shqiptare, në emër të popullit shqiptar, pasi për atë e kishte bërë luftën. Ajo nuk kontrollonte disa "fshatra, pjesë rruge, shpesh edhe disa godina", siç shpreheni ju, por gjithë hapësirën që ishte brenda kufijve të saj. Por në emër të lirisë e të sigurisë së atdheut e të kombit, jo për të qenë në gjendje "të ndërmerren veprimtari të kriminalitetit të organizuar praktikisht sipas dëshirës së tyre", siç shpreheni ju në pikën 85 të raportit, pasi ata i kishin dhënë raport me gjakun e tyre dhe populli kishte besim të plotë në drejtësinë dhe lirinë që ua kishte sjellë UÇK-ja. Dhe të jeni i sigurt se UÇK-ja u ka dhënë një ndihmë të madhe edhe KFOR-it edhe UNMIK-ut për ta marrë drejtësinë dhe vendosur kontrollin në Kosovë. E ato kur u vendosën në Kosovë, gjithkund ku kanë shkuar, kanë gjetur luftëtarët e UÇK-së dhe gjithçka në rregull. Por korrigjoni shprehjen e emërimit të UÇK-së fraksione, grupe kriminale e të tjera, pasi atë fazë fyerjesh e akuzash ajo e ka kaluar në vitet 1996 - 1997. Më vonë u vlerësua se nuk qëndronin akuzat e fyerjet e tilla dhe bota e mori dhe e bëri mashkë qytetare të botës moderne.

Ndërsa Thaçi nuk është e vërtetë se "u vet-shpall Kryeministër i qeverisë së përkohshme të Kosovës", siç e cilësoni në pikën 86 të raportit. Ai zotëri e mori këtë detyrë me një marrëveshje politike kombëtare dhe me pajtimin e plotë ndërkombëtar. Pse nuk i keni pyetur pjesëmarrësit në Konferencën e Rambujesë? Nëse gjithçka që nuk ka kaluar nëpër duart e dyert tuaja e të Serbisë quhet e paqenë, mund të shpreheni si të doni, por mund të

shpreheni vetëm për vete, ndoshta po ju pranuan, mund të shpreheni edhe për kombin tuaj, por nuk keni asnjë të drejtë të tentoni ta tjetërsoni historinë e kombit shqiptar. Dhe të jeni i sigurt që në ato momente Thaçi nuk kishte asnjë rival që duhej likuiduar siç deklaroni ju. Të gjithë ata që ishin në skenën politike të Kosovës edhe në kohën e Millosheviqit, janë edhe sot në skenën politike, pa asnjë shqetësim.

Dhe të jeni i bindur se po të kërkonte apo dëshironte të bënte atë që thoni ju, mund t'i kishte likuiduar se ishte komandant ushtrie. Por komandant ushtrie ishte për ta çliruar vendin e jo për të vrarë njerëz rrugëve të atdheut të çliruar me shumë mund. Po ku kupton ti zotëri nga qenia i pushtuar e çlirim prej robërie! Ashtu si nuk keni asnjë njohje për shqiptarët dhe vlerat e tyre për mbrojtjen e jetës.

Shikoni çfarë thoni në pikën 87: "Kur policia serbe dhe forcat paraushtarake u tërhoqën në qershor 1999, njësitë e UÇK-së të vendosura në Veri të Shqipërisë u përhapën në Kosovë me objektivin e shpallur për të "siguruar territorin", por edhe të nxitur nga ana tjetër nga një ndjenjë e papërmbajtshme zemërimi e, le ta themi hapur, hakmarrjeje ndaj të gjithë atyre që dyshoheshin prej tyre se kishin marrë pjesë në shtypjen e popullit të etnisë shqiptare". Duke bërë këtë deklaratë, ju kërkonin ta krijoni opinionin që në Kosovë nuk ka pasur UÇK-ja, se ajo ka qenë në Shqipëri dhe se vetëm pas përfundimit të goditjeve të NATO-s, ajo është futur në Kosovë. Po mirë more zotëri, po si do ta bindësh popullin e Kosovës për këtë që thua? Apo nuk marrin vesh gjë ata, pasi raportin e keni për Këshillin e Evropës.

Dhe sa mirë që paskan ikur forcat ushtarake, policore edhe paraushtarake serbe, se rrezik nuk do të ishin futur fare në Kosovë forcat e UÇK-së. Sa shakaxhi jeni zotëri Marty. Forcat ushtarake, policore, edhe paraushtarake serbe, ikën nga sytë-këmbët se, përndryshe, do të kishin vdekur. Këtë ta keni të qartë. Luftëtarët e UÇK-së nuk ishin sportistë, por luftëtarë që kishin synim lirinë ose rënien në altarin e saj.

Ama sa për urrejtje, forcat e UÇK-së në përfundim të luftës nuk kanë pasur fare, pasi gjithë urrejtjen e tyre të mbledhur në shpirtin e popullit shqiptar të pushtuar prej një shekulli luftëtarët e UÇK-së e kanë shfryrë kundër forcave ushtarake, policore edhe paraushtarake serbe për 2 vjet pa u ndalur dhe atë detyrë e kanë kryer mirë. Ndaj nuk kanë pasur nevojë për asnjë lloj hakmarrjeje se, po të kishin nevojë të tillë, do të kishit evidencuar shtëpi serbe të djegura, fëmijë, gra e pleq serbë të vrarë. Por nuk keni gjetur asnjë, se shqiptarët nuk janë kategoria juaj dhe e serbëve, të cilët kanë vrarë

mbi 12 mijë njerëz të paarmatosur të të gjitha moshave, deri edhe fëmijë të porsalindur apo në barkun e nënës. Ndërsa bashkëpunëtorët shqiptarë që kanë marrë armët e armikut, kanë veshur uniformën e armikut dhe janë rreshtuar në formacionet e armikut për të vrarë shqiptarë, të jeni i sigurt se kanë shkuar me serbët, atë ditë që kanë ikur ata prej Kosovës, për të mos u kthyer më kurrë. Megjithëse e di se ju akoma ëndëroni se mund të kthehen, ashtu siç ëndërrojnë serbët.

Po habitem me "faktin" që paskeni zbuluar se në Shqipëri në periudhën e Luftës Çlirimtare të Kosovës kishte "mungesë të rendit publik" dhe "paafësi të policisë dhe shërbimeve informative shqiptare për shtypjen e banditizmit mafioz, të organizuar e të ushqyer nga disa njësi të UÇK-së që ishin vendosur në Veri dhe në Qendër të Shqipërisë". Mirë t'ua bëni atyre, përderisa pranojnë që ju të flisni si të keni dëshirë, pa iu kërkuar llogari ndërkombëtarisht. Ata vërtet duhen konsideruar të paafët. Por unë di se kanë qenë në detyra dhe me ndjenjë të lartë përgjegjësie, pasi kam qenë aty dhe di mirë se çfarë ka ndodhur në atë terren gjatë luftës 1997 - 1999. Por, siç duket, Qeveria e Tiranës kur ju keni bërë deklaratat e ndyra, mendon se meqenëse kanë qenë në pushtet kundërshtarët e tyre politikë, shpifjet tuaja mund t'u shërbenin për disa vota më shumë sepse do t'i shfrytëzonin shpifjet tuaja si trampolinë.

Ashtu sikurse ka prova që të gjithë luftëtarët që kanë kaluar në rrugën për në front nëpër veriun e malësisë së Shqipërisë kanë qenë me shumë kulturë dhe shumë të komunikueshëm. Askush prej tyre nuk ka marrë edhe ujë në çezmë pa marrë leje. Dhe kjo nuk ishte iniciativë personale e luftëtarëve, por ishte direktivë e dhënë që nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, sepse kërkohej nga çdo luftëtar të fitonte ngado që të vepronte simpatinë dhe dashamirësinë e popullit të zonës sepse, zotëri Marty, luftëtarët e UÇK-së nuk ishin UFO, por bijtë më të denjë të popullit shqiptar, të cilët për hir të dashurisë për atë popull, kishin marrë armët e kishin dalë në male ta luftonin kuqëdrën serbe. Se po të ishte për të shitur drogë do të vinin të bënin një kontratë me ty atje në Zvicër e nga i keni ju ato territoret e trafikimit.

Në pikën 96 ju deklaroni evidentimin: "Vendet e burgimit - për të cilat morëm dëshmi të drejtpërdrejta nga burimet tona, të mbledhura nga elemente të mbledhura prej gazetarësh investigues (disa datojnë që prej dhjetë vjetësh a më shumë), dhe më pranë në kohë, të mbështetura nga përpykjet e hetuesve dhe prokurorëve të EULEX-it - përfshijnë: Cahan, Kukës (rrethina), Bicaj, Burrel, Rripe (fshat në jug-perëndim të Burrelit

në rrethin e Matit), Durrës, dhe ndoshta më i rëndësishmi nga të gjithë në kuadrin e mandatit tonë të veçantë, Fushë-Kruja".

Se çfarë paskan kërkuar luftëtarët me burgje në Burrel, Durrës e Fushë-Krujë, atë gjejeni meqë i keni hyrë kësaj pune. Unë nuk kam njohje për ato zona se nuk kanë qenë nën juridiksionin e detyrës dhe përgjegjësisë time. Por për në Cahan, Kukës dhe Bicaj, ju po mashtroni, pasi në ato vende nuk ishin të nevojshme burgjet. Pa folur që në Bicaj as që kanë shkuar ndonjëherë luftëtarët, se nuk i lidhte as rruga. Or zotëri, po ato janë vende të banuara more. Si mund të ngrihen burgje ilegale në mes të morisë së një populli të tërë e të intensitetit të lëvizjes së luftëtarëve? Ju jeni i pandalshëm për mbrapshti, zotëri!

Për ato qendra stërvitjeje dhe furnizimi që ka pasur UÇK-ja në territorin e Shqipërisë është e saktë që nuk kanë qenë të pavarura e autonome, siç thoni ju në pikën 98, kështu që vërtet nuk guxonte kush të ndërmerre asnjë veprim jashtë planit të veprimeve luftarake të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, pasi gjithë veprimtaria e tyre duhej ushtruar sipas misioneve që ai shtab ua kishte caktuar atyre qendrave. Dhe vërtet ato kishin komandantë shumë të devotshëm, të gatshëm për të siguruar një disiplinë dhe ndershmëri për t'u pasur zili. Por civilë në ato qendra mund të vinin vetëm ata që kishin vendosur të vishnin uniformën e luftëtarit të UÇK-së dhe për të shkuar në front. Ndërsa mund t'ju them me siguri të plotë, se pas datës 23 qershor 1999 në rajonin e Kukësit e, për rrjedhojë, edhe në vendet që emërtoni ju, si në Kukës, Bicaj e Cahan, nuk ka pasur asnjë luftëtar të UÇK-së, se të gjithë ishin futur në Kosovë për t'i kryer detyrat që u kërkohej në funksionet e tyre në radhët e UÇK-së nga komandat përkatëse. Për këtë mund t'ju them me siguri se gjithë zona është kontrolluar me kujdes të shtuar, jo për burgje, siç thoni ju, por që të mos kishte mbetur diku ndonjë armë, municion etj, që mund të gjendeshin nga qytetarët, të cilët mund të dëmtoheshin prej tyre. Çdo rajon e rrugë ku kanë qëndruar përkohësisht apo kanë kaluar luftëtarët të UÇK-së është kontrolluar nga specialistë të të gjitha armëve e shërbimeve ushtarake shqiptare, sepse dihet që në luftë mund të ndodhë që të mbetet edhe ndonjë armë apo municione të harruara apo nga pakujdesia, gjë që ndodh e ka ndodhur gjithnjë në luftëra.

Në pikën 104, pa asnjë ndjenjë përgjegjësie ju deklaroni: "Kjo politikë do jetë zbatuar me forcë në territor shqiptar nga elemente të fuqishëm të shërbimeve informative kombëtare, midis të cilëve SHIK (i shndërruar në SHISH) dhe nga shërbimet informative të ushtrisë, disa

anëtarë të së cilës do kenë marrë pjesë madje edhe gjatë marrjes në pyetje. Frymëzuesi kryesor i kësaj politike duhet të ketë qenë Kadri Veseli (alias Luli), një personazh-kyç i 'Grupit të Drenicës'. Nuk e kuptoj ku e merrni gjithë këtë guxim zotëri, sa të përgojoni me hamendje një shtet të tërë me gjithë organet e tij të sigurisë, që nuk më duket normale dhe jam i habitur se si ju është pranuar në Këshillin e Evropës kjo thashethemajë. Sa për dënimin tuaj, shërbimet që ju i merrni nëpër gojë nuk kanë pasur kohë të merren me burgjet tuaja imagjinare, pasi kanë pasur mjaft punë në detyrat e tyre, kur siguria e shtetit ishte e kërcënuar seriozisht nga agresioni kundërshqiptar serb e grek.

Ndërsa Kadri Veselin që e përmendni ju, sikur po përmendni një ushtar, duhet t'ju sqaroj se ai ka qenë funksionar i rëndësishëm në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e ishte në drejtim të veprimtarisë që kishte për detyrë të kryente. Ai nuk kishte kohë të sillej nëpër Shqipëri të merrte në pyetje të "burgosur", të cilët në imagjinatën tuaj kanë qenë në Kukës a diku tjetër në Republikën e Shqipërisë. Jo zotëri, ai ka qenë në Kosovë se atje ishte vendi i tij. Dhe kishte detyra shumë më të mëdha sesa të merrte në pyetje një qytetar, qoftë edhe armik i betuar i çlirimit të Kosovës. Por ju duhet t'i përgojoni emrat e drejtuesve të UÇK-së dhe nuk keni fare kornizë etike prej politikani apo diplomati, funksione për të cilat paguheni.

Ndërsa sa i përket të ashtuquajturit "Grupi i Drenicës", mund t'ju them se në prill të vitit 1999 kam qenë i pranishëm kur ka ardhur kolona e të shpërngulurve nga Drenica, në të cilën kishte vetëm gra, fëmijë e pleq, të gjithë në këmbë, të gjithë këmbëzbathur ose me ndonjë vjetërsirë që e tërhiqnin zvarrë, të gjithë të zbehtë, duke mbajtur njëri-tjetrin për dore, disa me ndonjë trastë të vogël në dorë dhe asgjë tjetër. Asnjë nuk qante, të gjithë shikonin drejt dhe serioz, asnjë nuk ankohej, asnjë nuk kërkonte ndihmë. Zotëri, kolonë të shpërngulurish më madhështore në vuajtjet e saj nuk kam parë as kam dëgjuar se mund të ketë. Këto mund të quhen Grupi i Drenicës, pa grupe të tjera nuk ka pasur, sepse me gjithë dëshirën tënde e shpifjet që keni ndërtuar, drenicasit e tjerë kanë qenë në frontin e luftës kundër pushtuesit, në përbërje të radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Termi "Grupi i Drenicës" është një shpikje e juaja, që nuk besoj se do të mbijetojë si etiketim, pasi është etiketim fals. Drenica nuk ka pasur një grup në luftë. Ajo, si edhe e gjithë Kosova, ka qenë e gjitha në luftë për ta shpërngulur njëherë e përgjithmonë kolonizatorin shekullor. (Vijon)

# Biseda e fundit e Giordano Brunos para se ta digjnin në furrë

Biseda e fundit e filozofit Giordano Bruno me nxënësin e tij Sagredo, pak para se ta digjnin për së gjalli në furrën e druve.

## Giordano BRUNO

Në korridorin e ngushtë, të errët dhe të gjatë të burgjeve të Kastel Sant'Angjelo dëgjohej hapa që shënojnë afrimin e mysafirëve ndaj burrave të dënuar dhe ekzekutimit të radhës.

Me një zhurmë të madhe të çelësve hapet dera e rëndë e qelisë aty ku rri mbyllur i dënuari me djegie në zjarr në furrën e druve: Giordano Bruno. Ai është aty, i shtrirë në kashtë të egër, ndërsa sytë e tij të ndritshëm, të mbajtur dhe të qetë, shkëlqejnë me gëzim dhe butësi në sytë e të ftuarit.

“Sagredo, shoku im i ri!” thërret filozofi i madh.

Të dy përqafohen, kujdestari del i heshtur, pas tij mbyll derën e qelisë së zhveshur dhe të lagur.

“Ti ke rrezikuar, bir. Inkuizicioni nuk ka simpati për ata që kanë simpati për heretikët”.

“Maestro, nuk mund të mos ju përhëndesja!”

I riu mezi fsheh emocionin e ballafaqimit me mjeshttrin e madh, tani afër ekzekutimit me një dënim të egër.

“Je bërë burrë tashmë dhe guximi yt do të të shpërblejë”.

“E kërkova nga Kardinal Bellarmino një leje të veçantë. Ai u tregua i mirë. Ndoshta diçka po ndryshon!”

“Po, po ndryshon”, konfirmon Bruno “edhe falë vdekjes sime: historia e kësaj bote është e shkruar më shumë me vdekje sesa me jetë. Vdekja ngjall frikë, shqetësim, pyetje, për më tepër, nëse është ilustruese. Kjo më bën të qetë, shoku im. E di se jam duke përmbushur fatin tim”.

“Maestro, s’ke frikë nga zjarri që do të ta djegë mishin?”

“Po, Sagredo, kam frikë. Trupi im ka frikë...” (reflekton mbi ‘trupi im’), por unë e di që nuk do të vdes... kur trupi im fizik të vdes, unë do të jem atje; do ta shoh trupin tim të bjerë, do t’i shoh fytyrat triumfuese, të habitura dhe të mërzhitshme të persekutuesve të mi...”

(Pavarësisht prej fjalëve të maestros, fytyra e të riut është e trishtuar).

“Nëse nuk të kisha lajmëruar... për arrestimin e vajzës dhe të dashurës tuaj, ju nuk do të ktheheshit në Venecia...”, thotë ai, pothuajse për ta qortuar veten.

“Do të kthehesha gjithsesi, herët a vonë. Po vdekja e tyre ishte një sinjal për mua...” vazhdon Bruno me shikimin kthyer drejt

pafundësisë.

“Me sa butësi e vullnet e kam dashur atë grua... Dashuria, Sagredo, është forca më e madhe e natyrës... është jeta, shkrija e trupave të të dashuarëve... Afër saj ishte ndjenja e ëmbël e pafundme e shtëpisë, e botës reale, butësia e ëmbël që vetëm një grua inteligjente dhe e thellë mund të japë dhe marrë... Sa iluzion, sa injorancë...”

Njeriu s’është i keq, Sagredo. Ai është vetëm i pakënaqur. Mendja e tij e vogël është shkaku i pakënaqësisë së tij. Po, e dija që ato ishin marrë, gjithashtu, për dënimin e tyre. Lajmërimi yt ishte vetëm një konfirmim i trishtuar. Kur trupi im të digjet, unë do të jem i lirë, Sagredo, i lirë të bashkohem me ato, t’i përqafoj. Mos u shqetëso, shoku im... Ky ishte fati ynë i zakonshëm për të gjithë ata që kërkojnë të vërtetën, të dëbuar nga një botë që mbahet me gënjeshtër.

Do të vijë një ditë, Sagredo, kur njeriu do të zgjohet nga harresa dhe, më në fund, do ta kuptojë kush është me të vërtetë dhe kujt i ka dhënë frenat e ekzistencës së tij, për një mendje të gabuar dhe gënjeshtare që e bën dhe e mban të skllavëruar. Njeriu nuk ka kufij dhe kur një ditë do ta kuptojë këtë, ai do të jetë i lirë edhe këtu në këtë botë”.

Kthehet dhe shikon nxënësin e vet gati të ndritshëm.

“E ka parashikuar që nga kohët e lashta jeta...”

“Maestro, po pse ky fat i pamëshirshëm? Kush mund ta këtë dashur gjithë këtë?”

“Unë vetë, Sagredo, shumë kohë para se të lindja në këtë dimension.

Vdekja në zjarr e trupit fizik është një pastrim i thellë. Është pagëzim i zjarrit. Shumëkush e ka zgjedhur këtë vdekje jo vetëm si shembull për një humanizëm të mpirë, domethënës dhe mizor, por edhe për ta përmbushur detyrën që jeta na ka caktuar dhe të cilën e kemi pranuar me dëshirë për dashurinë.

Tekefundit, edhe pa vetëdije Kisha po përmbush vullnetin tonë”.

“Por atëherë... Kardinal Bellarmino bën vullnetin tonë?”

“Bellarmino tani kryen vullnetin e Kishës, që synon ruajtjen e pushtetit. Sidoqoftë, ai, gjithashtu, kryen vullnetin e vërtetë, atë të një vdekjeje ilustruese që lë gjurmë në histori.



Edhe njerëzit e kishave janë pjesë e Një-jes: vdekja ime do të shërbejë për ta treguar fuqinë e vërtetë, fuqinë okulte e cila lëviz prapa të gjitha kishave dhe të gjitha fuqive të botës.

Në këtë botë ilustruese, ku mbizotërojnë gënjeshtër, mirësia dhe frika hipokrite, një vdekje shembull është më e efektshme sesa një jetë e tërë.

Njerëzit humanë e mbajnë mend. Njeriu që shkakton vdekje është ai që i frikësohet më së shumti vdekjes. Është paradoksale, por kush sjell vdekje në mënyrë të dëshpëruar, përpiqet ta kuptojë atë, të depërtojë në mendjen e Zotit”.

“Pra, Bellarmino... edhe ai është në kërkim të Zotit?”

“Sigurisht, edhe Bellarmino është një vëll”.

“Maestro, po pse e gjithë kjo?!”

Pse gjithë kjo vuajtje, këto mizori, padrejtësi, dhimbje: vëllezër që vrasin vëllezërit e tyre?! Si mund ta firmosë me aq shpirtlehtësi Bellarmino dënimin e vdekjes tuaj?”

“Ai nuk bëri me aq shpirtlehtësi, Sagredo. Ishte një vendim i dhimbshëm dhe i vuajtur për të, por ai nuk mund të bënte ndryshe. Ai duhej të hiqte dorë nga veshja që vesh dhe nga besimet që predikon. Ai s’ka vetëdije. Nuk e ndien unitetin e universit të pafund. Nuk e di se veprimi i tij sot do të ketë një reagim për të në jetën e tij të ardhshme, në të ardhmen. Kjo vlen edhe për mua dhe të gjithë ata që janë përpjekur kot ta zgjojnë njerëzimin nga mashtrimi.

Toka është një shkollë e vështirë: çdo veprim lë gjurmë, sepse ekziston drejtësia e vërtetë, bir, edhe pse nuk shfaqet në këtë botë”.

“Drejhtësia e vërtetë dëshiron vdekjen tuaj?”

“E dëshirojmë vetë, Sagredo, jo trupat tanë kalimtarë, por qeniet

e vërteta të pavdekshme që jemi. Na pëlqeu apo jo, ne jemi shkaku i vetvetes. Qenia nuk i frikësohet vdekjes, sepse e di mirë se nuk ekziston. Duke lindur në këtë botë, ne biem në iluzionin e shqisave; besojmë në atë që shfaqet. Injorojmë se jemi të verbër dhe të shurdhër.

Atëherë frika na sulmon dhe harrojmë se jemi hyjnorë, që mund ta ndryshojmë rrjedhën e ngjarjeve, edhe Zodiakun...”

Ne jemi fëmijë të diellit të vetëm të vërtetë që ndriçon botën.

Dhimbja dhe vuajtja nuk ishin aty në fillim të historisë, në kohën e Egjiptit të lashtë i cili akoma ruan kujtesën e origjinës së saj të lavdishme dhe të pavdekshme.

Një ditë, jo shumë larg, një epokë e re më në fund do të vijë në Tokë. Vdekja nuk ekziston. Mjermimi, dhimbja dhe tragjeditë e saj të shumta janë rezultat i frikës dhe mosdijes për atë që është realiteti i vërtetë”.

“Ma, edhe sa kohë duhet?”

“Koha varet edhe nga ne, Sagredo. Koha është intervali mes konceptimit të një ideje dhe manifestimit të saj...”

Njerëzimi konceptoi mikrobin e utopisë dhe gestacioni vazhdon drejt përmbushjes së tij të pashmangshme: shekulli i kaluar është një fazë e rëndësishme e cila i paraprin lindjes. Qeniet hyjnore vëzhgojnë gestacionin e Tokës dhe disa kanë lindur këtu për t’i ndihmuar njerëzit të kuptojnë se transformimi, gjithashtu, varet nga zgjimi i tyre”.

“Edhe ju, maestro, zbritët këtu për këtë qëllim?”

“Edhe unë, Sagredo, por nuk jam vetëm. Ekziston një grup i madh i qenieve që kanë zbritur disa herë përgjatë historisë dhe e njohin veten në të madhin Ermete, Sokrat, Pitagora, Platone, Empedokle...”

Në këtë shekull, Leonardo,

Mikelangjelo, Shekspiri, Kampanela, emra të njohur, por edhe njerëz të përlur, shërues të thjeshtë, shumë prej të cilëve përfunduan të djegur në kunjë”. (Giordano mallëngjehet nga kujtimi i shumë personave që i paraprijnë atij në rrugën e tëmthit).

Giordano vazhdon: “Është pagëzimi i zjarrit që shërben për ta përvetësuar trupin fizik dhe për të manifestuar qenie të vërteta. Zbulesa e tyre tani është e pashmangshme. Nuk e di kur, por e di se shumë prej nesh kanë ardhur në këtë shekull për të zhvilluar arte dhe shkencën, për t’i hedhur farat e kulturës së re që do të lulëzojë papritur, pikërisht kur pushteti do të jetë nën iluzionin që ka fituar”.

Zhurmat në prapavijë sugjerojnë që vizita duhet të përfundojë. Frymëmarrja e Sagredos sa s’ndalet...”

“Maestro, si mund të të gjej?”

“Shiko brenda vetes, Sagredo, dëgjoje zërin tënd të brendshëm dhe mbaje mend se maestro i vetëm i vërtetë është qenia që pëshpërit brenda teje. Dëgjoje: është e vërteta dhe është brenda teje. Ti je hyjnor. Kurrë mos e harro”.

Hapet dera e qelisë dhe paraqitet kujdestari. Duket një fytyrë e një burri të vështirë, por që ka edhe frikë nga ai njeri, burgosësi i të cilit e sheh veten. Ai nuk thotë asnjë fjalë dhe pret me respekt që vizitori të largohet.

Giordano dhe Sagredo ngrihen dhe përhëndesin njëri-tjetrin, të dy të mallëngyer.

“Ne nuk po ndahemi Sagredo. Ndarja nuk ekziston. Jemi të gjithë një, në kontakt të përvetshëm me shpirtin unik...”

(Publikuar në numrin e tetë të revistës “Akademia” që sapo ka dalë nga shtypi. Përktheu nga italishtja: Leonora Buçinca)

# STOP



Nga: Xhevdet BAJRAJ

Një përgjigje për disa që më japin publikisht këshilla miqësore (e që nuk i kam as miq në rrjetin Facebook) në lidhje me atë se çka është poeti dhe, më tej, cili është vendi i poetit në një shoqëri. Ya basta! Poezia ka turp për shumicën absolute të poetëve të sotëm, e liria turpërohet nga ju. Ata që ju i njihni si poetë (se unë nuk e di kënd e quani ju ashtu), e që janë larg jetës së njeriut a kombit, ata janë edhe larg, shumë larg, tepër larg, poezisë. Një ditë një kafshë apolitike u fut mes ezanit të hoxhës dhe të një vargu tim?! Dje mora shumë 'udhëzime' dhe 'këshilla' rreth një postimi?!

Këto më bëjnë të kuptoj se për disa nuk qenka e mjaftueshme ajo që them përmes vargut. Pajtohem se jeta e çdo njeriu të thjeshtë, të zakonshëm, është e vështirë, por rruga e artistit është plot gjemba, prandaj edhe me lehtësi e ngatërrojnë artistin me iriqin. Jeta është një lojë, dhe si në çdo lojë, të fitosh ose të humbësh nuk është njësoj. Artistët, në këtë rast poetët, janë lojtarë që nuk heqin dorë. Në fund të fundit, atyre nuk intereson ajo thënia se gjëja më e rëndësishme në një lojë është të marrish pjesë e jo të fitosh. Këtë e dinë mirë edhe fituesit edhe humbësit. Letërsia vazhdon të jetë një punë serioze, e jo argëtim i lehtë. Realiteti e ka komoditetin të duket jo i besueshëm. Poezia, arti, nuk e ka këtë komoditet, se përndryshe nuk do t'i shërbente njeriut e as njerëzimit. Një numër i konsiderueshëm i pushtetarëve tanë, përdorin të

gjitha stilet e notit, në lumin tonë të jetës, në lumin tonë të shterur të jetës, në brigjet e të cilit akoma nuk janë zhdukur njollat e gjakut të njerëzve tanë. Pra, është koha e fundit, që secili të ulet aty ku e ka vendin, në spital psikiatrik, në burg apo në një karrige që ia caktoar historia, qoftë në pjesën e errët, qoftë në pjesën e ndritshme të saj. Mua nuk më pëlqen ky realitet i krijuar, prandaj nuk mund të rri duarkryq, ajo që më së paku mund të bëjë, është të shkruaj poezi dhe, nëpërmes saj, të mund të dal së paku nga ky realitet. Tekfundit, letërsia ekziston sepse nuk i mjafton realiteti, çfarëdo qoftë ai, besa nuk i mjafton jeta më gjithë çka ka. Një poet nga Amerika veriore thoshte: "Poeti është një kafshë detare, që jeton në tokë dhe do të dëshironte të fluturojë". E tërë bota duket se është shndërruar në një spital të madh. Mbrojtja nga kjo

"ngrehinë" është arti. Arti është vet liria, me të poetët përballen çdo ditë, duke u përpjekur t'i japin kuptim. Në poezi kjo do të thotë ta asimilosh, mbizotërosh gjendjen në të cilën e ke gjetur ofertën estetike (po ashtu atë etike), dhe ta përshkosh, ta bësh një hap më tutje, në të panjohurën, nuk është edhe aq vështirë, traditën e ke me vete. Përndryshe njeriu akoma do ta ndizte zjarrin me fërkimin e dy krandeve apo goditjen e dy gurëve mes veti. (Ky ka qenë hap i madh për njerëzimin, hapi tjetër i madh ka qenë kur kanë vizatuar me gaca të fikura në shpella.) Nga ajo liri vjen originaliteti, një nga gjërat më të rëndësishme në poezi, në art në përgjithësi, dhe ai vjen, ekskluzivisht, nga sinqeriteti. Natyrisht, Salman Rushdie do të thoshte, duhet të jeni vrazhdësisht të ndershëm me vetveten. Unë nuk shkruaj për t'i argëtuar masat e gjëra

popullore që gjenden në kllapi, por për ta zgjuar ndonjërin prej tyre nga ajo kllapi, t'ia prishi ëndrrën e keqe. Kosova është një kapitull tragjik i historisë, po për fatin tonë të mirë, me një fund të bukur. Ama... kujdes, është vetëm një kapitull. Në kapitullin në vazhdim, drita e lirisë po shfaq shumë probleme, herë fiket, herë ndizet. Dhe, kur ndizet drita, ajo është shumë e zbehtë, dhe këtyre që nuk shohin mirë nga interesat personale, u mjegullohet realiteti aq shumë, sa që fiket edhe drita e diellit. Ata që na sollën deri këtu, uzurpuesit, kapësit, dhunuesit, shkatërruesit, përvetësuesit, krimbat e lirisë, unë nuk do t'i përkrah më, sepse jam i lirë dhe nuk ka njeri që e shporr lirinë nga qenia ime. Të jesh i lirë do të thotë të mund ta zgjedhësh edhe të keqen, ama ja që ky nuk është opsion për mua. P.S. "Shqiptarët duhet të jenë të denjë, për të qenë shërbëtorët e Shqipërisë", Mithat Frashëri. /Telegrafi/



## Filmi "Zana" me premierë në Spanjë

Filmi i cili trajton jetesën e së tashmes, ndikuar nga e kaluara, respektivisht ndikimin e luftës kolektive te individi, "Zana" do ta ketë premierën në festivalin Mostra de Valencia në Spanjë. Këtë e bëri të ditur regjisorja e filmit, Antoneta Kastrati përmes një statusi në Facebook:


"Shumë e lumtur që Zana do ta ketë premierën në Spanjë në festivalin "Mostra de Valencia", ka shkruar regjisorja. Për filmin, është shkruar edhe një artikull nga organizatorët e Festivalit: "Nga Kosova vjen "Zana", shfaqja debutuese e Antoneta Kastrati. Një perspektivë e re për konfliktin në Ballkan. Filmi

herë pas here përdor elemente fantazie për të reflektuar në tmerrin e luftës. Me protagonistin e luajtur nga Adriana Matoshi, ky debutim i jashtëzakonshëm nga kineasti kosovar me seli në SHBA u zgjodh të përfaqësonte vendin e tij në Oskarë dhe fitoi Grandmimin Grand Juria në Los Angeles", shkruan artikulli i Mostra de Valencia.



**E jashtëzakonshme**

# I panjohuri ua paguan borxhet të varfërve



Një ngjarje e pazakontë ka ndodhur në Tuzla të Turqisë. Një person i panjohur po ua paguan borxhet të varfërve, por askush nuk e di se për kë bëhet fjalë. Burri misterioz u ka lënë disa familjeve zarfe me lekë poshtë derës, në një kohë kur varfëria dyshohet si shkak kryesor i vetëvrasjeve që ka "pushtuar" Turqinë aziatike së fundmi. "Dikush erdhi dhe më kërkoi t'i tregoj fletoren ku unë regjistroja borxhet e klientëve", i tha agjencisë së lajmeve 'Demirwren', pronari i njërit prej dyqaneve.

## BARSOLETA E DITËS



Nxënës të shkollës fillore po ecnin rrugës, kur papritmas shohin një çift të sapomartuarish duke dalë nga kisha. Një nga fëmijët më çapkën u thotë shokëve:

"Ja se çfarë është paniku!"  
I afrohet dhëndrit, e kap për dore dhe i thotë: "Tung babi!"



## Në Kino ABC nuk ka shfaqje



**FOTO E DITES**



Delfinët në gjirin e Ftelesë në kanalin e Korfuzit

**E rrallë**

# Delja shitet në ankand për 367 mijë paund

Një dele e quajtur "Double Diamond" u shit në një ankand në Texel, Skoci, për 367 000 mijë paund. Ofertat për delen filluan nga 10 500 paund dhe më pas u rritën në mënyrë drastike. "Oferta përfundimtare për blerjen e deles vendosi 'një çmim të ri rekord në Mbretërinë e Bashkuar dhe në botë për një dele', sipas një deklarate në faqen e internetit të Texel Sheep Society.



 <p><b>DASHI</b> Ditë shumë e vështirë kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Nuk do të merrni vesh për asgjë me personin që keni në krah.</p>	 <p><b>DEMI</b> Të dashuruarit do t'ia kalojnë mirë pranë partnerit të zemrës dhe do të jenë të gatshëm për të marrë vendime me rëndësi.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Beqarët do të jenë më shumë fat në dashuri dhe do të mund të fillojnë një lidhje goxha të qëndrueshme dhe afatgjatë.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Do të kaloni një ditë shumë të qëndrueshme gjatë kësaj dite. Me partnerin do të flisni hapur për gjithçka dhe do të bashkëpunoni fort.</p>	 <p><b>LUANI</b> Ditë tejet e qëndrueshme kjo e sotmja për të dashuruarit. Me mirëkuptim dhe dashamirësi do t'i zgjidhni të gjitha problemet që keni pasur.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Sot nuk do të merrni vesh për asgjë me partnerin tuaj dhe në disa momente do të debatonit fort me të.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Do të ketë konflikte kalimtare sot në jetën tuaj në çift, megjithatë atmosfera do të jetë përgjithësisht e ngrohtë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Marrëdhënia në çift do të jetë shumë e ngatërruar gjatë kësaj dite. Do të keni herë pas here debate të forta me partnerin.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot do të dëgjoni me kujdes partnerin tuaj dhe nuk do të bëni asnjë veprim që mund të bie në kundërshtim me idetë e tij.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Sot dita do të jetë e mrekullueshme nëse bëni kujdes me xhelozinë dhe tregoheni disi më i hapur.</p>	 <p><b>UJORI</b> Gjithçka do të shkëlqejë sot në jetën tuaj në çift. Do ta joshni pa fund njëri-tjetrin dhe çastet e lumtura do të jenë me të shumta se më parë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Do të jeni shumë diplomatë ju të dashuruarit dhe do të dini si ta mbani pas vetes partnerin tuaj.</p>

## Fejohet Liam Payne, i dhuron të fejuarës unazën e cila kushton 3.3 milionë funte



**L**iam Payne dhe e dashura e tij Maya Henry janë të fejuar pas lidhjes për dy vjet, raporton DailyMail. Ish-anëtar i "One Direction", 26-

vjeçar, ia propozoi të dashurës një unazë diamanti të mahnitshme, e cila kushton hiç më pak se tre milionë funte 3.3 milionë euro.



## Kejvina Kthella nxjerr pistoletën

**K**ejvina Kthella ka pozuar së fundmi me një stil shumë ndryshe nga sa jemi mësuar ta shohim në rrjete sociale. Ajo ka zgjedhur një palë rroba të zeza dhe me një pistoletë e kapuç në kokë,

duket fiks si një "Gansta girl". Kanatierja e hapur dhe e çarë në anë, i nxjerr në pah gjoksin dhe belin e hollë. Mes maskës, sytë e shkruar e bëjnë atë të duket edhe më sensuale.

## Gjiko, entuziast për projektin e ri: Kur qeveria ta dëgjojë këtë këngë do t'i hapë diskotekat



**G**jiko në bashkëpunim me Melindën do të sjellin brenda pak ditëve këngën e tyre të re, për të cilën dyshja kanë premisa të mëdha. Reperi ka publikuar disa imazhe në


llogarinë e vet në "Instagram" nga klipi i punuar, duke shkruar se kur qeveria ta dëgjojë këtë këngë, do t'i hapë diskotekat. Gjiko në fotografimin e postuar shihet me shampanjë në dorë.

## Brad Pitti, në lidhje të re me modeluesen gjermane



Brad Pitti dhe Angelina Jolie janë ndarë që prej vitit 2016, por duket se ende nuk po finalizojnë dot divorcin. Së fundmi, arsyeja ishte se Angelina donte një gjykatës tjetër, me pretendimin se ai që ishte caktuar kishte lidhje me avokatin e Pittit. Burimet thonë se aktorja ka ndjenja urrejtjeje dhe dashurie për Bradin, prandaj nuk dëshiron t'ia japë divorcin.

Mirëpo, gjatë kësaj kohe Brad nuk ka qëndruar single, përkundrazi e ka shfrytëzuar kohën për t'u njohur me gra të tjera. Së fundmi, aktori i famshëm po përflitet për një lidhje të re me një modele gjermane, e quajtur Nicole Poturalski. Ai është fotografuar me modeluesen 27-vjeçare, e cila ngjan shumë me Angelinën, duke hipur në një avion privat.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## MKRS-ja investon 25 mijë euro në fushat sportive në Kërpimëh

PRISHTINE, 28 GUSHT - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka vizituar sot Komunën e Podujevës. Dumoshi ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit me kryetarin e Podujevës, Nexhmi Rudari, për fushat sportive në Kërpimëh, të cilat janë investim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vlerë prej 25 mijë eurosh, projekt ky që do të implementohet gjatë vitit 2020. Ministrja Dumoshi ka thënë se ndihet tepër e lumtur që pati rastin ta vë gurthemelin në Kërpimëh si ministre e

Kulturës, Rinisë dhe Sportit në qeverinë Mustafa dhe që po e sheh këtë projekt të jetësuar në këtë mandat. Ky përkushtim tregon edhe gatishmërinë e qeverisë Hoti për ta përkrahur rregullimin e infrastrukturës sportive, gjithmonë në dobi të qytetarëve të Kosovës. Kryetari Rudari në anën tjetër e falënderoi ministren Dumoshi për vizitën në Podujevë dhe u shpreh shumë i kënaqur që kjo komunë është prioritet për MKRS-në sepse vërtet qytetarët e Podujevës kanë nevojë për kushte më të

mira sportive, rinore e kulturore. Vizitën në Podujevë ministrja Dumoshi e vazhdoi bashkë me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, me të cilin shpërndau maska në kuadër të projektit "Be with us", projekt ky i mbështetur nga Ambasada e Japonisë në Kosovë, UNICEF dhe organizata PEN. Ministrja Dumoshi e ka zhvilluar këtë aktivitet në funksion të respektimit të masave anti - Covid 19 për sensibilizimin e qytetarëve e sidomos të rinjve për luftimin e pandemisë.



### SHKURT

#### Ekipi Olimpik i xhudos po përgatitet në Turqi

Ekipi Olimpik i xhudos po merr pjesë në kampin përgatitor bashkë me Kombëtaren e Turqisë në qytetin e Erzurumit, në lartësi mbidetare mbi 2 mijë metra. Komiteti Olimpik i Kosovës do t'i mbulojë shpenzimet, bazuar në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KOK-ut për mbështetje të sportistëve elitare për përgatitje jashtë vendit. Ndërsa përgatitjet do të zgjasin deri më 6 shtator. Xhudistët do t'iu rikthehen garave me Grand Slamin e Budapestit, që mbahet prej 23-25 tetor 2020. Gara është e vlefshme për pikë Olimpikë "Tokyo 2020".

#### SC Gjilani: Djegia e flamurit të Greqisë, akt jo i hijshëm

Skuadra e Gjilanit e ka dënuar veprimin e tifozëve të cilët të enjten në mbrëmje e dogjën flamurin e Greqisë. "Pas veprimeve të disa individëve gjatë zhvillimit të takimit Gjilani - APOEL, kanë djegur flamurin e Greqisë dhe Sport Club 'Gjilani' dënon rënd këtë akt jo të hijshëm. Vepra të tilla nuk kanë vend në sportin më të popullarizuar në botë, aq më pak neve si komb ku duhet të jemi shembull në mikpritjen e ekspeditave udhëtuese në vendin tonë", thuhet në njoftimin e SC Gjilani.

#### Fenerbahçe kërkon 20 milionë euro për Muriqin

Klubi i Fenerbahçes po kërkon 20 milionë euro për sulmuesin Vedat Muriqi i cili po kërkohet nga Lazio. Këtë e ka konfirmuar presidenti i klubit turk, Ali Koc. "Ne duam 20 milionë euro për ta liruar Muriqin. Nëse ai do të qëndrojë me ne, do të jemi favoritë për titull dhe falë paraqitjeve të tij ne do të jemi në gjendje ta shesim për një shifër më të lartë vitin e ardhshëm", ka thënë Koc.

#### Vëllaznimi prezanton edhe dy futbollistë

Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova po vazhdon transferet në këtë afat kalimtar. Klubi kuqezi duket se ka ambicie të mëdha në edicionin e ri futbollistik në Ligën e Parë. Vëllaznimi të enjten prezantoi tre futbollistë, kurse të premtën edhe dy të tjerë. Bëhet fjalë për Raul Pllumbin, qendërmbrojtës i ardhur nga Lezha, dhe Muhamed Berisha, i cili u rikthye nga A&N.

## Jep dorëheqje bordi i KB Rahoveci

RAHOVEC, 28 GUSHT - Klubi i Basketbollit Rahoveci ka mbajtur të enjten kuvendin e rregullt të punës, në të cilin janë diskutuar raporti i punës dhe ai financiar. Para diskutimit është bërë një rikapitulim i punës dhe aktiviteteve të bordit në vitet e fundit, por edhe për vështirësitë financiare sidomos në muajt e fundit pas suspendimit të ligës. Me shumicën e anëtarëve të pranishëm dhe me dy abstenime, në kuvend janë votuar të dy raportet.

Klubi i Rahoveci ka njoftuar se ka dhënë dorëheqje bordi i klubit. "Në punimet e Kuvendit dorëheqje në tërësi kanë dhënë të gjithë anëtarët e deritanishëm të



bordit. Dorëheqja ka ardhur përkundër shumë përpjekjeve që të zgjidhen problemet financiare për çka ka qenë e pamundur, duke pasur parasysh edhe situatën e pandemisë, por edhe rrjedhimisht mosndarjen e mjeteve të zotuar nga Komuna e Rahovecit, për çka ishte planifikuar buxheti për edicionin e kaluar", thuhet në njoftimin e Rahovecit.

Bordi i dorëhequr falënderon gjithë ata që ndër vite kanë mbështetur klubin në ngritjen e cilësisë, por edhe në plotësimin e ëndrrave të shumë gjeneratave që qyteti të ketë skuadër elitare në basketboll.

## Drita i drejtohet Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv

**GJILAN, 27 GUSHT** - Skuadra e Dritës do të apelojë në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv (CAS) përjashtimin nga Liga e Kampioneve pas rregullave të reja të UEFA-s gjatë pandemisë koronavirus. "Bardhekaltrit" besojnë se

humbja në tavolinë ndaj ekipit të Linfieldit (3:0), ishte e padrejtë dhe kësaj janë optimistë që do të marrin një dëmshpërblim të majmë. UEFA në koordinim me autoritetet e Zvicrës kishte anuluar takimin për shkak se

dy futbollistë të Dritës kishin dalë pozitivë në testin për Covid-19. Drita ka angazhuar avokatin zviceran Luca Tettamanti, i cili do t'i ndjekë procedurat për ta apeluar rastin. Në një prononcim për "Associated Press", Tottenham

ka theksuar se është duke proceduar me fakte. "Ne jemi duke proceduar rastin bazuar në fakte", deklaroi Tettamanti për "AP". Ndërkohë, Drita do t'i vazhdojë garat në kualifikimet e Ligës së Evropës, ku është në pritje të kundërshtarit.



## 12 vjetët e kaluara në Kosovë ishin të mrekullueshme

**PRISHTINË, 28 QERSHOR** - Një nga organizatorët më të mirë pasluftës në basketbollin e Kosovës padyshim ishte Samir Shapatahoviqi. Basketbollisti shqiptar filloi rrugëtimin në basketbollin e Kosovës nga Prishtina. Me treshet e tij nga largësia, asistimet dhe luftën në parket, fitoi zemrat e adhuruesve të basketbollit të Kosovës. Samiri luajti edhe për Mabetexin, Bashkimin dhe Pejën, duke fituar shumë trofe. Në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së, ai flet që nga debutimi në moshën 14-vjeçare, për rrugëtimin në basketbollin e Kosovës, për idhullin e tij, kundërshtarin më të vështirë, ndeshjet më të veçanta dhe mesazhin për të rinjtë.



### Si vendose të luaj basketboll?

Në kohën kur kam filluar të luaj basketboll nuk ke pasur shumë zgjidhje, ose rrugën e keqe ose të merreshe me sport. Unë zgjodha rrugën e mirë dhe familjes time, që të merrem me sport. Basketbolli ka qenë sporti i parë dhe i fundit sport që unë e kam dashur. Iniciatori më i madh ka qenë babai im Arifi (i cili ka ndërruar jetë). Babai im ka qenë vetë sportist dhe më kujtohet secila këshillë në atë kohë të vështirë. Sigurisht në atë kohë nuk ka qenë aspak e lehtë për mua, sepse të gjithë e dinë sa respektohen shqiptarët në Mal të Zi. Baras me zero. Por fati dhe puna ime e palodhshme më ka bërë të dallohem prej të gjithë fëmijëve të tjerë. Me 14 vjet kam debutuar për skuadrën e parë të Mornar Bar. Ka qenë ëndrra ime që të jem në skuadrën e parë, që më është realizuar në atë kohë.

**Cili ka qenë idhulli yt në fëmijëri?** Secili prej neve si në atë kohë, gjithashtu edhe tash, nuk ka pasur tjetër idhull përveç të vetmit Michael Jordan.

**Cili ka qenë trofeu më i rëndësishëm për ty dhe pse?** Secili trofe i fituar ka të veçantat e

veta. Shumë vështirë të përcaktohes se për cilën Kupë. Por, një gjë e di sigurt, që ai që e fiton është ndjenja më e bukur në jetë. Në basketbollistët vetëm një ëndërr e kemi. Të bëhemi kampionë të shtetit ku luajmë.

### Cilën ndeshje nuk mund ta harrosh asnjëherë?

Ndeshjen kur kam luajtur në Mornar Bar. Isha vetëm 17-vjeçar dhe kemi luajtur kundër Crvena Zvezdas në Tivar. Kam shënuar 38 pikë. Ishin edhe udhëheqësi dhe lojtarë të Prishtinës dëshmitarë në atë ndeshje. Ka qenë edhe ndeshja kundër Efes Pilsen në Turqi dhe Prishtinë. Gjithashtu, edhe ndeshja Prishtina - Mabetex. Por, ka pasur edhe takime të tjera si, Peja - Prishtina në finale të Play-off-it dhe ajo Peja - Teodo Tivat.

### Cili ka qenë kundërshtari më i vështirë që je ballafaquar?

Nuk kam pasur edhe kundërshtarë aq cilësorë. Sepse kam pasur shumë vetëbesim në veten time dhe e kam konsideruar veten që jam bindshëm më i mirë. Unë do ta citoj legjendën e basketbollit kosovar dhe evropian, Ferid Zekolli, i cili njëherë më ka thënë: Unë

bashkëlojtarët e mi i kam problemin më të madh. E pyes pse, dhe ai më përgjigjet sepse po më pengojnë t'i shkatërroj kundërshtarët. E vërteta është që më ka ndodhur mua kjo shumë herë. Me mua mund 'të matet' vetëm Artan Mehmeti, por nuk e tregoj arsyen. Shpresoj se do ta takoj një ditë dhe ta përsëndes.

**Sa të mungon basketbolli dhe atmosfera nga koha kur ke luajtur?** Basketbolli në veçanti më mungon shumë. Më mungojnë edhe tifozët, stërvitjet dhe përgatitjet për lojë. Në veçanti më mungon secila fjalë basketboll.

### Cili është mesazhi për lojtarët e rinj që duan të merren me basketboll?

Mesazhi im për të rinjtë është i njëjti me atë që i them edhe djalit tim. Është lehtë të jesh një person i keq, por problem të jesh njeri i mirë. Fillimisht duhet të jetë njeri, të largohet nga rrugët e këqija, me qenë afër familjes së tij. Sporti në veçanti duhet të jetë në mendjen e një adoleshenti. Kam kaluar 12 vjet të mrekullueshme në Kosovë që nuk do t'i harroj asnjëherë. Zoti i ruajt të gjithë shqiptarët!

## Edhe një lojtar i Romës infektohet me koronavirus

Sulmuesi i Romës, Carles Perez, të enjten konfirmoi se në testin e bërë për Covid-19 ka rezultuar pozitiv. Të premtën ka ardhur një tjetër lajm jo i mirë për tifozët romakë, pasi edhe një lojtar tjetër është infektuar me koronavirus. Bëhet fjalë për mbrojtësin e krahut të djathtë, Bruno Perez. "Përsëritjet e gjithëve, për fat



të keq unë rezultova pozitiv me Covid-19 pas testit, por dua t'ju them se jam shumë mirë dhe nuk kam asnjë simptomë. Tani do t'i respektoj ditët e izolimit në shtëpi dhe shpresoj që të jem në gjendje të punoj me pjesën tjetër të ekipit për fillimin e sezonit. Shihemi së shpejti dhe përgjithmonë. Forza Roma", ka shkruar 30-vjeçari.

## SHKURT

### Rrethi i dytë, 'ferr' për klubet shqiptare

Teuta, Kukësi dhe Laçi iu gëzuan një ditë më parë kualifikimit në turin e dytë të Europa League, por për të kaluar më tej do të jetë një mision i pamundur. Mjafton ta shikosh listën e ekipeve me të cilat mund të përballen për ta kuptuar. Tottenham dhe Milan janë mes klubeve që shorti mund t'ua rezervojë tri ekipeve të Superiores dhe Renovës, klubi shqiptar i Maqedonisë së Veriut që u kualifikua një ditë më parë. Klubet e Superiores rrezikojnë të përballen edhe me Shkëndijën e Tetovës, në një derbi mes shqiptarësh, apo edhe klube si Basel, Wolfsburg, Galatasaray, Granada, Reims e shumë të tjera të forta. Skuadra e Ernest Gjokës është te favoritët për shkak të koeficientit, por do t'i duhet pak fat në short, pasi ka mjaft rivalë të rrezikshëm si Osijek, Olimpija, Hammarby e Bodo-Glimt.

### Fury: Joshuan mund ta mposhti në raundin e parë

Pas deklaratës së Anthony Joshuas, që ka thënë se e mposht Tyson Fury brenda raundit të 6-të, ka ardhur reagimi i këtij të fundit. Fury, kampion bote në peshën e rëndë në kategorinë WBC, ka thënë se atij i mjafton një raund për ta mposhtur patriotin e tij. "Unë mund ta mposht Joshuan që në raundin e parë", shkruan Fury në rrjetet sociale. Palët kanë kohë që po punojnë mes tyre për të organizuar në vitin 2021 një sfidë në peshën e rëndë mes dy kampionëve të botës (Joshua mban titujt e kategorive IBF, WBA dhe WBO). Fury, i pamposhtur (30 fitore e 1 barazim), pritet ta zhvillojë sfidën e tretë ndaj Deontay Wilder, po këtë vit. Ndërsa Joshua, 23 fitore e 1 humbje në karrierë, pritet të duelojë në fund të këtij viti ndaj bullgarit Kubrat Pulev.

### Silva prezantohet te Chelsea

Chelsea ka zyrtarizuar transferimin e mbrojtësit brazilian Thiago Silva. Futbollisti Silva ka nënshkruar kontratë njëvjeçare, me mundësi vazhdimi edhe për 12 muaj të tjerë. Ai është shprehur shumë i lumtur për këtë transferim. "Jam shumë i lumtur që po bashkohem me Chelsean. Jam i entuziazmuar të jem pjesë e skuadrës së Frank Lampardit për sezonin tjetër dhe jam këtu të luftoj për trofe", ka thënë Silva, që u largua nga PSG-ja si transferim i lirë. Ky është përforsimi i pestë i Chelseat në këtë afat kalimtar.

### Kloppi: Nuk ka asnjë shans që Messi të transferohet në Liverpool

Lajmi që Leo Messi do të largohet nga Barcelona ka vënë shumë skuadra me financa të mira në radhë për argentinasi, por një nga skuadrat bën përjashtim dhe ajo është Liverpooli. Trajneri Jurgen Klop e ka konfirmuar se nuk ka asnjë shans që Liverpooli ta blejë yllin argentinasi. "Interes për Messin? Kush nuk e dëshiron Messin në skuadër? Por, nuk ka asnjë shans. Shifrat nuk janë për ne, kështu që ne as nuk duhet ta mendojmë për të. Është e qartë, nuk ka asnjë shans që Messi të vijë te Liverpooli. Por...lojtar i mirë, të jem i sinqertë", ka thënë Klop.

### Barça e interesuar ta shkëmbejë Griezmannin me Felixin

Gazeta madriline "Marca" ka raportuar se Barcelona po tenton shkëmbimin e Antoine Griezmann me Joao Felixin e Atletico Madridit. Gjasat janë të pakta që të realizohet, me Atletico që nuk mund t'i lëndojë tifozët me rikthimin e një lojtari që vendosi t'i bashkohej mes polemikave Barcelonës verën e shkuar. Javët në vazhdim do të jenë vendimtare për këtë lëvizje "bombë" në afatin kalimtar të verës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas  
Municipality  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/461  
Më: 28.08.2020  
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

**NJOFTIM PËR PËR PËRMIRËSIM TË KONKURSIT**

Në konkursin e shpallur me datë 25.08.2020 dhe publikuar në gazetën "Epoka e Re" me datën 26.08.2020 faqe 19, është lëshuar një gabim teknik, ku nuk është cekur nr.i prot 13/492.

Datë:28.08.2020  
Dragash

Drejtori i DKA-së  
Msc. Vloran Cenaj

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lumë's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

**PRISHTINË**

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

- ▶ Gezim Selmani shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Emin Kasami shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Remzi Banovi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Lirik Spahiu shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

